



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.117

15 nëntor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2006	Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri.....	4669
Dekret nr.5101 datë 2.11.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	4670
Vendim i KM nr.727, datë 1.11.2006	Për shkrirjen e Drejtorisë së Informacionit Agroushqimor	4671
Vendim i KM nr.729, datë 18.10.2006	Për dhënien me qira, pa konkurrim, shoqërisë “Univers-Alb” sh.a. Tiranë, të disa mjediseve në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, Tiranë.....	4671
Udhëzim i MPÇSSHB nr.90/1, datë 16.1.2006	Për procedurën e organizimit të komisionit të licencimit të ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore.....	4672
Udhëzim i MPÇSSHB nr.338/3, datë 10.3.2006	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kriterëve , të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike".....	4675
Udhëzim i MBUMK& MPÇSSHB nr.497 datë 6.3.2006	Për llogaritjen e të ardhurave që sigurohen nga prodhimi bujqësor dhe blegtoral.....	4691
Udhëzim i MPÇSSHB nr.1956, datë 19.9.2006	Për një ndryshim në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.1281, datë 15.7.2004 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.1766/1, datë 17.9.2003 “për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimin nga statusi i të verbërit” (i ndryshuar).....	4692

Udhëzim i MPÇSSHB nr.1957, datë 19.9.2006	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.619, datë 7.9.2006 “Për disa ndryshime në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar”.....	4693
Udhëzim i MPÇSSHB nr.1959, datë 19.9.2006	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”	4693
Marrëveshje ndërinstitucionale bashkëpunimi datë 25.10.2006	Për monitorimin e fushatës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.....	4694
Udhëzim i KQZ nr.7, datë 20.10.2006	Për administrimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.....	4695
Udhëzim i KQZ nr.8, datë 30.10.2006	Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore nga organizatat joqeveritare, shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediae	4699
Vendim i KMBSH nr.80, datë 25.10.2006	Për disa ndryshime në rregulloren “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.....	4702
Vendim i KKRT nr.515/1, datë 9.10.2006	Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Real”	4703
Vendim i KNSH nr.2, datë 20.10.2006	Për skemën ekzistuese për huanë e butë që jepet për makineritë bujqësore dhe për linjat e agropërpunimit.....	4705
Vendim i KNSH nr.3, datë 20.10.2006	Për përjashtimin nga akciza e karburantit të përdorur në linjat e agropërpunimit.....	4706
Vendim i KNSH nr.4, datë 20.10.2006	Për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e përpunimit të qumështit, ullirit, rrushit dhe bluarjes së grurit.....	4706
Vendim i KNSH nr.5, datë 20.10.2006	Për skemën ekzistuese të subvencionimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit.....	4707
Vendim i KNSH nr.6, datë 20.10.2006	Për planin për dhënien e ndihmës shtetërore shtëpisë botuese “Naim Frashëri”	4708
Vendim i KNSH nr.7, datë 20.10.2006	Për miratimin e udhëzimit “Për paraqitjen e ankesave për ndihmat e paligjshme dhe vlerësimin e ndihmave të paligjshme”	4708
	Njoftim për vende vakante për noter.....	4711
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të personave: Ndue Gjin Sana, Artan Sagrini, Ermira Nilaj, Gjin Grishaj, Kreshnik Bjeshka, Bude Dizdari, Marjana Narkaj, Ardian Gjilaj.....	4711
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Klodian Kaptelli.....	4711
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Pëllumb Qamil Malko.....	4711

REZOLUTË

PËR DËNIMIN E KRIMEVE TË KRYERA NGA REGJIMI KOMUNIST NË SHQIPËRI

1. Kuvendi i Shqipërisë u referohet Rezolutave të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe konkretisht: Rezolutës 1096 (1996) "Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste"; Rezolutës 1481 (2006) "Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste", si dhe vendimeve të Konventës së Parë Kombëtare të Shoqatës Mbarëkombëtare për Integrimin e të Përndjekurve Politikë dhe Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës "Për dënimin e krimeve të komunizmit në Shqipëri", datë 12.5.2006.

2. Regjimi totalitar komunist i Enver Hoxhës dhe klikës së tij, që qeverisi Shqipërinë pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1990, u karakterizua nga: dhunimi masiv i të drejtave të njeriut, vrasjet dhe ekzekutimet individuale e kolektive (me dhe pa gjyq), vdekjet në kampet e përqendrimit, vdekjet nga uria, torturat, dëbimet, puna skllavëruese, terrori fizik dhe psikologjik, gjenocidi për shkak të origjinës politike apo trashëgimisë së pronës, si dhe dhunime të lirisë së ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes, lirisë së shtypit, lirisë së besimit fetar dhe lirisë së pluralizmit politik.

3. Partitë që juridikisht trashëguan strukturat, anëtarësinë dhe pronat e PPSH-së, nuk kanë shprehur deri sot vullnetin për t'u distancuar nga regjimi totalitar komunist, nga "lufta e klasave" dhe "diktatura e proletariatit", si dhe krimet e Enver Hoxhës dhe klikës së tij.

4. Rënia e regjimit komunist në Shqipëri nuk u pasua me një hetim të krimeve të kryera prej tij, aq më tepër që autorët e këtyre krimeve nuk u përballën asnjëherë seriozisht me drejtësinë dhe nuk u kërkuan falje publike viktimave të gjenocidit komunist.

5. Ndërgjegjësimi i opinionit publik shqiptar, sidomos i brezit të ri, për krimet çnjerëzore të kryera nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës është mjaft i dobët.

6. Kuvendi i Shqipërisë shpreh bindjen se njohja dhe denoncimi i krimeve të diktaturës komuniste i shërben shmangies së përsëritjes së krimeve të ngjashme në të ardhmen. Ndëshkimi i krimeve të kryera dhe rivlerësimi real i historisë luan një rol të rëndësishëm në edukimin e brezave të rinj.

7. Kuvendi i Shqipërisë dënon fuqimisht dhunimin masiv të të drejtave të njeriut të kryer nga regjimi totalitar komunist i Enver Hoxhës dhe klikës së tij.

8. Kuvendi i Shqipërisë dënon diktatorin Enver Hoxha si ideatorin, frymëzuesin, drejtuesin dhe ekzekutuesin e sistemit më të egër diktatorial komunist në Europën Lindore, që çoi në izolimin dhe varfërimin e tejskajshëm të Shqipërisë dhe kërkon heqjen e të gjithë titujve dhe dekoratave të dhëna atij e bashkëpunëtorëve të tij nga regjimi komunist.

9. Kuvendi i Shqipërisë kërkon rishikimin e datave simbol të sistemit komunist, që shënojnë instalimin e diktaturës komuniste në Shqipëri, si dhe heqjen e këtyre datave nga protokollet zyrtare shtetërore.

10. Kuvendi i Shqipërisë kërkon bërjen publike të të gjitha dokumenteve që dëshmojnë krimet e regjimit komunist, përfshirë edhe dosjet e krijuara në ish-institucionet e përndjekjes dhe dënimeve politike, si Sigurimi i Shtetit, prokuroritë, gjykatat dhe komitetet e dëbim-internimeve.

11. Kuvendi i Shqipërisë kërkon hapjen e dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit për politikanët, drejtuesit e institucioneve kushtetuese, atyre të sistemit të drejtësisë, të administratës publike qendrore e vendore, si dhe të mediave kombëtare audio-vizive apo të shkruara.

12. Kuvendi i Shqipërisë fton partitë komuniste dhe postkomuniste në Shqipëri, që të rikonsiderojnë historinë e komunizmit dhe të kaluarën e tyre, të distancohen qartësisht nga krimet e kryera nga regjimi komunist dhe nga diktatori Enver Hoxha, duke i dënuar ato pa asnjë mëdyshje.

13. Kuvendi i Shqipërisë fton akademikët, historianët dhe ekspertët e pavarur që t'i intensifikojnë kërkimet e tyre për përcaktimin dhe verifikimin objektiv të historisë së Shqipërisë gjatë diktaturës komuniste.

14. Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se viktimat e krimeve të regjimit totalitar komunist, si dhe familjet e tyre, meritojnë respekt dhe mirëkuptim për vuajtjet e tyre, si dhe mirënjohje për qëndresën e tyre ndaj diktaturës.

15. Kuvendi i Shqipërisë mbështet hartimin e një strategjie kombëtare për eliminimin e pasojave të totalitarizmit gjysmëshekullor në Shqipëri dhe fton institucionet shtetërore të përmbushin të gjitha detyrimet ligjore lidhur me statusin e të përndjekurve politikë për integrimin, arsimimin, punësimin,

strehimin dhe dëmshpërblimin e tyre në një kohë sa më të shpejtë, si dhe akordimin e një fondi për gjetjen e të zhdukurve dhe të varrëve me apo pa gjyq për arsye politike.

16. Kuvendi i Shqipërisë nxit fillimin e një fushate kombëtare për ndërgjegjësimin rreth krimeve të kryera në emër të ideologjisë komuniste, duke përfshirë rishikimin e librave shkollorë, shpalljen e një dite kombëtare për përkujtimin e viktimave të komunizmit, hapjen e muzeve, përfshirë edhe kthimin në muze të burgjeve të tmerrshme politike, si dhe ngritjen e memorialeve në nderim të shqiptarëve që u vranë për kundërvënien ndaj regjimit totalitar.

17. Kuvendi i Shqipërisë mbështet organizimin e një konference kombëtare me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Parlamentit, Qeverisë, partive politike, shoqatave të të persektuarve, akademikëve, historianëve, si dhe ekspertëve të OJF-ve për krimet e kryera nga regjimet totalitare komuniste.

Tiranë, më 30.10.2006

DEKRET
Nr.5101, datë 2.11.2006

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------------------|---|
| 1. Nora Qazim Lataj | 20. Besnik Myri Dashllari |
| 2. Erza Esat Cermjani | 21. Ralf Besnik Dashllari |
| 3. Lolzim Zyhdi Aoshi | 22. Artur Hysen Koçja |
| 4. Ornela Llambro Spaho | 23. Fazilet Reshat Weißmüller (Barbullushi) |
| 5. Bashkim Zeqir Matmuja | 24. Ilir Halil Muka |
| 6. Ali Can Ligataj | 25. Artan Muharrem Xhafa |
| 7. Sara Skender Schmidt (Agaj) | 26. Dhurata Isak Azizi (Faqolli) |
| 8. Elion Kosta Pogaj | 27. Gjergj Gjon Meshaj |
| 9. Petrit Engjell Pilkati | 28. Lavdosh Hekuran Qori |
| 10. Diana Halit Pilkati (Nelaj) | 29. Alice Lavdosh Qori |
| 11. Devi Petrit Pilkati | 30. Ujbjën Lavdosh Qori |
| 12. Danjela Skënder Gaba (Muharremi) | 31. Etleva Pandeli Qori (Komini) |
| 13. Oliveta Doitsidis (Veseli) | 32. Mirela Esat Oktrova |
| 14. Adela Syrja Rjepaj (Tare) | 33. Bora Bardhyl Demiraj |
| 15. Nesti Jorgji Gollosi | 34. Renald Kudret Metoja |
| 16. Kristjan Nesti Gollosi | 35. Eno Stavri Vangjeli |
| 17. Kristina Nesti Gollosi | 36. Rezart Sazan Matlliu |
| 18. Alexander Nesti Gollosi | 37. Klea Rezart Matlliu |
| 19. Vije Kozma Gollosi (Dufa) | 38. Nertila Ferit Shabani |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.727, datë 1.11.2006

PËR SHKRIRJEN E DREJTORISË SË INFORMACIONIT AGROUSHQIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkrirjen e Drejtorisë së Informacionit Agroushqimor (Shtëpia e Propagandës Bujqësore), në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
 2. Arkivi i filmit dhe atij dokumentar të depozitohen pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
 3. Dorëzimi dhe marrja në dorëzim e mjeteve, në përdorim të Drejtorisë së Informacionit Agroushqimor (DIA), në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të bëhen sipas bilancit kontabël në datën e dorëzimit dhe të marrjes në dorëzim. Afatet e dorëzimit dhe të marrjes në dorëzim caktohen me urdhër të Ministrit.
 4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
 5. Shkronja “b” e pikës 2 të vendimit nr.28, datë 19.2.1970 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
 6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.729, datë 18.10.2006

**PËR DHËNIEN ME QIRA, PA KONKURRIM, SHOQËRISË “UNIVERS-ALB” SHA, TIRANË,
TË DISA MJEDISEVE NË SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 803 e 901 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie me qira, pa konkurrim, shoqërisë “Univers-Alb” sh.a., Tiranë, të disa mjediseve, me sipërfaqe truall gjithsej 15 638 m² në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, Tiranë, institucion në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes, për ngritjen e një qendre spitalore.
2. Afati i kontratës së qirasë të jetë 20 (njëzet) vjet.
3. Autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për lidhjen e kontratës së qirasë, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin nr.315, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.90/1, datë 16.1.2006

PËR PROCEDURËN E ORGANIZIMIT TË KOMISIONIT TË LICENCIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të pikës 13 dhe 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.564, datë 12.8.2005 “Për licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”,

UDHËZOJ:

1. Komisioni i licencimit të ofruesve të shërbimeve dhe përkujdesjes shoqërore funksionon si organ konsultativ i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

2. Komisioni i licencimit shqyrton:

a) aplikimet për pajisjen me licencë dhe rilicencim nga ofruesit e shërbimeve shoqërore publike dhe jopublike;

b) propozimet e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore për ofruesit që nuk zbatojnë standardet e shërbimeve shoqërore.

3. Dokumentacioni i aplikimeve për pajisjen me licencë për ofrimin e shërbimeve sociale, që përgatitet nga Shërbimi Social Shtetëror, si dhe propozimet e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore, regjistrohen në protokollin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. Drejtoria e Shërbimeve Sociale informon me shkrim kryetarin e komisionit të licencimit, mbi aplikimet për licencim dhe propozimet e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore, nëse ka të tilla, duke i propozuar datën për mbledhjen e komisionit. Kryetari i komisionit vendos për datën e mbledhjes së komisionit, duke pasur në konsideratë afatin e përcaktuar në pikën 9 të vendimit nr.564, datë 12.8.2005 “Për licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, si dhe njofton me shkrim anëtarët e komisionit.

5. Drejtoria e Shërbimeve Sociale i paraqet kryetarit të komisionit të licencimit kopjen origjinale të dokumentacionit për licencim, ndërsa anëtarëve kopjen fotokopje 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

6. Dokumentacioni për licencim përbëhet nga:

a) dokumentacioni që ka paraqitur aplikuesi;

b) vlerësimi i Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore.

7. Komisioni i licencimit mblidhet kur është e pranishme shumica e anëtarëve të tij. Pasi bën vlerësimin e kërkesës për licencim, dokumentacionit të çdo aplikanti, në përfundim të çdo mbledhjeje vendos t’i propozojë Ministrit:

a) miratimin për pajisjen me licencë;

b) refuzimin për pajisjen me licencë;

c) miratimin për rinovimin e licencës;

d) refuzimin për rinovimin e licencës;

e) miratimin ose refuzimin e propozimeve të Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore kur ka të tilla.

8. Anëtarët e komisionit të licencimit shprehen për çdo aplikues dhe çdo propozim. Për rastet kur licenca ose propozimi refuzohet, komisioni paraqet me shkrim argumentimin përkatës.

9. Çdo anëtar komisioni ka të drejtë të shprehë mendimin e tij me shkrim, në rastet kur ka

mendime të ndryshme mes anëtarëve për vendimin e marrë. Këto mendime pasqyrohen në dokumentacionin që i dërgohet për miratim ose refuzim Ministrit.

10. Ministri, pasi është njohur me materialin propozues të Komisionit, vendos për miratimin ose refuzimin e tij. Në rastet kur miratohet pajisja me licencë, Drejtoria e Shërbimeve Sociale përgatit licencën përkatëse, e cila firmoset nga Ministri. Në rastet kur nuk miratohet pajisja me licencë, Drejtoria e Shërbimeve Sociale njofton zyrtarisht aplikantin për refuzimin e pajisjes me licencë, për pezullim ose heqje licence duke përmendur në njoftim argumentet dhe afatin kohor të ankimit. Ky njoftim firmoset nga Ministri.

11. Në rastin e miratimit nga Ministri, të propozimeve të Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, atëherë Drejtoria e Shërbimeve Sociale njofton subjektin përkatës brenda 7 ditëve.


12. Licenca do të ketë formatin, që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

13. Licenca merret në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale nga aplikanti ose nga një përfaqësues i tij. Për të tërhequr licencën, i interesuari duhet të paraqesë faturën për pagesën e tarifës përkatëse.

14. Udhëzimi nr.1321/10, datë 3.12.2003 “Për licencimin e personave juridikë privatë, përfshirë edhe OJF-të për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE
TË BARABARTA
Koço Barka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA

L I C E N S Ë

Nr. _____, datë _____, 2006, Nr. _____ Prot

Në mbështetje të Ligjit nr. 9355, dt. 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të VKM nr. 564, dt. 12.08.2005 "Për licensimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore" dhe të Udhëzimit të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. _____ dt. _____ 2006 "Për procedurën e organizimit të Komisionit të Licensimit të ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore", pas shqyrtimit të përputhshmërisë së kërkesave ligjore dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur, me propozim të Komisionit të Licensimit, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

V E N D O S I:

Të njohë dhe të licensojë ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore nga subjekti _____, për shërbime _____, në adresën _____.

Kjo licensë është e vlefshme _____ vjet nga data e marrjes së saj.

KOÇO BARKA

Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZIM
Nr.338/3, datë 10.3.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.787, DATË 14.12.2005
"PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE , TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS
EKONOMIKE"

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

I. Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të plotësojë familja pretenduese për ndihmë ekonomike është:

1. Deklarata mod.1 “Për gjendjen ekonomike dhe sociale të familjes”, e cila plotësohet nga kryefamiljari një herë në vit dhe:

- a) në muajin e parë të pretendimit për ndihmë ekonomike;
- b) sa herë ndryshojnë kushtet shoqërore-ekonomike të familjes;
- c) kur familja rikthehet në skemën e ndihmës ekonomike pas një periudhe ndërprerjeje të pagesës.

2. Deklarata mod.2 “Për paraqitjen mujore të familjes” plotësohet, detyrimisht çdo muaj, dhe firmoset nga anëtarët madhorë të familjes pretenduese për ndihmë ekonomike.

3. Certifikata e gjendjes familjare e familjes pretenduese për ndihmë ekonomike, e cila duhet të pajiset me shënimet përkatëse si:

- a) data e regjistrimit në vendbanimin e ri dhe emri i vendbanimit të vjetër, në rastet kur familja e ndryshon vendbanimin e saj pas datës 1 gusht 1991;
- b) “banor i vjetër”, në rastin kur familja nuk e ka ndryshuar vendbanimin e saj ose e ka ndryshuar atë para datës 1 gusht 1991;
- c) data e ndarjes nga trugu familjar për familjet që ndahen pas 1 gushtit 1991.

4. Familja bujqësore duhet të paraqesë çdo vit dokumentin e pronësisë mbi tokën të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (Kadastra), në të cilin të shënohet sipërfaqja e tokës dhe kategoria e saj.

Në muajin e parë të pretendimit për ndihmë ekonomike familja bujqësore do të dorëzojë në seksionin e mbrojtjes shoqërore në bashki e komuna një kopje të noterizuar të këtij dokumenti, ndërsa në vitet në vazhdim ky dokument do të jetë i fotokopjuar dhe i vendosur në dosjen e familjes përfituese.

5. Për kushte të veçanta shoqërore-ekonomike dhe shëndetësore të familjes, administratorët shoqërorë duhet të kërkojnë edhe dokumente shtesë plotësuese si:

- a) vërtetim nga reparti ushtarak kur kryefamiljari apo një anëtar i familjes kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak;
- b) vërtetim nga drejtoria e burgut kur kryefamiljari apo një anëtar i familjes vuan dënimin me heqje lirie;
- c) vërtetim nga prokuroria kur kryefamiljari apo një anëtar i familjes është në gjendje arresti të përkohshëm për çështje penale;
- d) vërtetim nga spitali, i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën shqipe, kur kryefamiljari apo një anëtar i familjes është jashtë shtetit për kurim;
- e) vërtetim nga shkolla kur kryefamiljari apo një anëtar i familjes është duke ndjekur studimet e mesme, të larta brenda dhe jashtë vendit me ose pa bursë;
- f) vendimin e gjykatës të fotokopjuar, si dhe vërtetim nga zyra e përmbarrimit në rastet kur palët kanë të mitur në ngarkim dhe nuk e zbatojnë vendimin e gjykatës për detyrimin ndaj tyre.

Në rastet e sipërpërmendura (nga germa a deri në germën d), trajtimi i familjes me ndihmë

ekonomike do të bëhet vetëm për anëtarët e pranishëm të saj.

6. Për jetimët të përcaktuar në germën b dhe c të pikës I/1 vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005, administratori shoqëror kërkon zyrtarisht nga SHSSH-ja një vërtetim që individi ka përfutur statusin e jetimit.

Jetimët të cilët kanë krijuar familje, do të trajtohen me ndihmë ekonomike në të njëjtat kushte dhe në të njëjtën masë si dhe anëtarët e familjeve të tjera.

7. Trajtimi i prindërve të fëmijëve trinjakë e më shumë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë, nuk do të kushtëzohet me trajtimin e familjeve në skemë, por me gjendjen social-ekonomike të tyre, të verifikuar nga administratori shoqëror.

8. Anëtarët e familjes bujqësore që banojnë në fshat, nuk konsiderohen si punëkërkues të papunë, sepse ata ushtrojnë aktivitet në bujqësi dhe sigurojnë përfitime nga toka dhe blegtoria.

9. Anëtarët e familjeve bujqësore që banojnë në fshat e kanë marrë tokë në zonat e kripura ose nuk kanë marrë tokë pasi me vendim të Këshillit të Ministrave toka është cilësuar zonë urbane, e zënë me hidrocentrale, ujësjellës ose ndonjë vepër tjetër, duhet të regjistrohen si punëkërkues të papunë në zyrat e punësimit.

10. Anëtarët e familjeve bujqësore që ndryshojnë vendbanimin e tyre nga fshati në qytet duhet të regjistrohen si punëkërkues të papunë në zyrat e punës në vendbanimin e ri, në qoftë se ato, sipas legjislacionit në fuqi, i plotësojnë kushtet për përfitimin e ndihmës ekonomike.

II. Administratorët shoqërorë në bashki dhe komuna:

1. Përpilojnë listat me emrat e anëtarëve madhorë (nga mosha 18 vjeç e lart) të familjeve që kanë paraqitur kërkesën për të përfutur ndihmë ekonomike.

2. Dërgojnë një kopje të listave të përcaktuara në pikën II/1 të këtij udhëzimi, të gjitha institucioneve të përmendura në pikën 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005.

3. Lista e përcaktuar në pikën II/1 të këtij udhëzimi, dërgohet çdo fillim viti me emrat e të gjithë pretenduesve dhe çdo muaj për pretenduesit e rinj, që në muajin e parë të pretendimit të tyre. Lista formulohet sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

III. Seksionet e mbrojtjes shoqërore në bashki e komuna u dërgojnë listat institucioneve, duke marrë konfirmimin e këtyre të fundit për marrjen në dorëzim të listave. Administratorët shoqërorë nuk do t'u japin ndihmën ekonomike familjeve pretenduese pa ardhur konfirmimi i kontrollit të listave nga institucionet përkatëse.

IV. Institucionet janë të detyruara që brenda 10 ditëve nga data e marrjes së listave, të kthejnë përgjigje zyrtare sipas specifikave të tyre dhe konkretisht:

1. Zyra e punësimit, për personat (emër, atësi, mbiemër) që rezultojnë:

a) të punësuar nga zyrat e punësimit, ose në rastin kur ata janë të regjistruar si të punësuar pranë kësaj zyre;

b) personat punëkërkues të papunë, që futen në kurse formimi, duke përfshirë pagesën e përfitimit dhe kohën e formimit;

c) personat punëkërkues të papunë, që refuzojnë të hyjnë në kurse formimi;

d) personat punëkërkues të papunë me përfitim pagesë papunësie;

e) personat punëkërkues të papunë, që refuzojnë vende pune apo pjesëmarrje në programe të tjera shtetërore.

2. Zyra e tatim-taksave, për personat (emër, atësi, mbiemër) që rezultojnë me veprimtari ekonomike private.

3. Zyra e sigurimeve shoqërore për:

a) personat (emër, atësi, mbiemër) që përfitojnë pension, si dhe masën e përfitimit të tij nga pensioni i pleqërisë, pensioni familjar, si dhe

b) personat që paguajnë kontribut sigurimi vullnetar.

4. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të gjithë personat (emër, atësi, mbiemër) që kanë prona, si dhe llojin e pronës në dispozicion, duke përfshirë edhe tokën bujqësore.

5. Zyra e regjistrimit të automjeteve, për të gjithë personat (emër, atësi, mbiemër) që kanë në pronësi automjete.

6. Inspektorati Shtetëror i Punës, për të gjithë personat (emër, atësi, mbiemër) që janë të punësuar e të paregjistruar, që rezultojnë të tillë nga kontrollet e ushtruara nga inspektorët e këtij institucioni.

7. Seksionet pranë bashkive dërgojnë listat e personave sipas specifikave të tyre, si më poshtë vijon:

a) seksioni i tregut të lirë, për të gjithë personat (emër, atësi, mbiemër) që tregtojnë në tregjet e lira;

b) seksioni i urbanistikës, për të gjithë personat (emër, atësi, mbiemër) që kanë leje ndërtimi apo që ndërtojnë pa leje;

c) seksioni i transportit, për të gjithë personat (emër, atësi, mbiemër) që kanë leje për transport mallrash, transport udhëtarësh e leje për tregti ambulante;

d) seksioni i kulturës, për të gjithë personat (emër, atësi, mbiemër) që merren me shpërndarjen e shtypit periodik;

e) seksioni i energjetikës, për të gjithë personat (emër, atësi, mbiemër) që merren me tregtimin e lëndëve djegëse.

V.1 Në rastin kur kryefamiljari nuk e tërheq ndihmën ekonomike nga arka e bashkisë apo komunës brenda 6 ditëve kalendarike nga momenti i tërheqjes së fondeve nga banka, atëherë familja e tij nuk përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike në qoftë se ajo ka pasur një fatkeqësi apo sëmundje gjatë kësaj periudhe.

2. Raste fatkeqësie në kuptim të pikës 1 të sipërpërmendur janë:

a) vdekja e një anëtari të familjes, e vërtetuar kjo me certifikatën e tij të vdekjes;

b) vdekja e një personi të afërm të familjes, si nënë, baba, motër, vëlla, të vërtetuara këto me certifikatat përkatëse të vdekjes;

c) shtrimi në spital i një anëtari të familjes, i shoqëruar ky me dokumentin përkatës nga spitali.

VI.1 Kur familja ka qenë e trajtuar me ndihmë ekonomike në vendbanimin e mëparshëm e brenda një muaji nga data e muajit të fundit të trajtimit me ndihmë ekonomike regjistrohet në vendbanimin e ri, atëherë, në qoftë se vazhdon të plotësojë kushtet për përfitimin e ndihmës ekonomike në vendbanimin e ri, sipas legjislacionit në fuqi, anëtarët e saj madhorë duhet të paraqesin edhe këto dokumente nga vendbanimi i tyre i mëparshëm:

a) vërtetim nga zyra e punësimit;

b) vërtetim nga zyra e sigurimeve shoqërore;

c) vërtetim nga zyra e tatim-taksave;

d) vërtetim nga zyra e regjistrimit të automjeteve;

e) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

2. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të sipërpërmendur, do të paraqitet vetëm një herë në muajin e parë të pretendimit të tyre për ndihmë ekonomike, së bashku me vërtetimin e lëshuar nga seksioni i mbrojtjes shoqërore në vendbanimin e mëparshëm, i cili duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) identitetin e kryefamiljarit (emri, atësia, mbiemri);

b) anëtarët e tjerë të familjes (emri, atësia, mbiemri);

c) numri i saj i dosjes;

d) masa e ndihmës ekonomike që ka përfituar;

e) periudha e përfitimit (data e fillimit dhe ajo e mbarimit);

f) adresa e vendbanimit të ri (emri i bashkisë apo i komunës).

3. Vërtetimi i përcaktuar në pikën IV.2 të sipërpërmendur duhet të firmoset nga drejtori i zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në vendbanimin e mëparshëm pas regjistrimit në regjistrin përkatës. Vërtetimi plotësohet sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Familjet të cilat e kanë ndryshuar vendbanimin e tyre sipas pikave 8 dhe 9 të vendimit, duhet të dorëzojnë në seksionin e mbrojtjes shoqërore të vendbanimit të ri kopjen e noterizuar të librezës së punës ose vërtetimin nga qendra e punës të firmosur e vulosur nga titullari i saj (si në rastin e familjeve të ushtarakëve), të cilat të vërtetojnë punësimin e tyre në vendbanimin e ri që në

çastin e lëvizjes.

VII. Zyra rajonale e Shërbimit Sociale Shtetëror duhet:

- a) të hapë regjistrin me të dhënat analitike për familjet të cilat ndryshojnë vendbanimin;
- b) të dërgojë çdo muaj pranë zyrave rajonale pritëse listat me emrat e familjeve të shpërngulura;
- c) të dërgojë çdo muaj pranë Shërbimit Social Shtetëror listat me emrat e familjeve që kanë ndryshuar vendbanimin.

VIII.1 Familjet e invalidëve të punës, të cilët përfitojnë nga ligji nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar, përfitojnë ndihmë ekonomike sipas legjislacionit në fuqi duke përjashtuar nga të ardhurat e familjes:

- a) të ardhurat nga invaliditeti (kur personi plotëson njëkohësisht kushtet për pension invaliditeti dhe pleqërie dhe ka zgjedhur pensionin e pleqërisë, për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi të trajtohet si invalid, duke iu referuar nenit 6 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”);
- b) mjetet lëvizëse dhe pajisjet e ndryshme ortopedike (neni 8 ligji nr.7889, datë 14.12.1994);
- c) të ardhurat nga punësimi (neni 14 i ligjit nr.7889, datë 14.12.1994).

2. Familja e invalidit të punës, për përfitimin e ndihmës ekonomike, duhet të plotësojë të gjitha kriteret e saj, duke përjashtuar nga të ardhurat ato sipas germave a, b, c të pikës VIII.1 të këtij udhëzimi.

3. Për përfitimin e ndihmës ekonomike, familja e invalidit të punës duhet të paraqesë edhe këtë dokument:

a) Vërtetimin e lëshuar nga KMCAP-i me të dhënat përkatëse, i firmosur nga drejtori i drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore të rrethit përkatës. Ky vërtetim përsëritet sa herë që invalidi rikomisionohet.

IX. Nuk konsiderohet ndarje spekulative e familjes dhe për rrjedhojë do të përfitojnë ndihmë ekonomike familjet, të cilat:

- a) janë ndarë pas datës 1 korrik 1993, si rrjedhojë e krijimit të një kurore të re;
- b) janë prishur si kurora, për shkak të divorcit të anëtarëve të saj apo vdekjes së njërit prej bashkëshortëve;
- c) familjet me kryefamiljarë vajza nëna.

X.1 Në të ardhurat e familjes nuk do të llogariten të ardhurat që marrin nga programi i pagesave për aftësinë e kufizuar (invalidët e punës, të verbërit, paraplegjikët e tetraplegjikët dhe personat me aftësi të kufizuar).

2. Administratorët shoqërorë të ruajnë në dosjen e përfituesit dokumentacionin e mëparshëm, si dhe të plotësojnë dosjen me dokumentacionin e ri, sipas pikës 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005.

XI. Seksionet lokale të ndihmës ekonomike duhet të arkivojnë këto dokumente:

- a) projektvendim,
- b) vendim,
- c) bordero pagese,
- d) regjistër,
- e) dosjen e legjislacionit.

1. Projektvendimi, numër, datë, bashkë me listat bashkëngjitur, përgatitet në tri kopje nga administratori shoqëror, nga të cilat:

- një kopje për zyrën e ndihmës ekonomike;
- një kopje për këshillin e bashkisë ose komunës;
- një kopje për zyrën rajonale.

2. Projektvendimi do të përmbajë:

- nr. rendor, emrin dhe mbiemrin e kryefamiljarit, nr. e dosjes, nr. e frymëve, llojin e

ndihmës ekonomike, e plotë apo e pjesshme, periudha e përfitimit, si dhe masa e ndihmës.

- emrat e pretenduesve që nuk përfitojnë ndihmë ekonomike për arsye të caktuara (si gjendje e mirë ekonomike, të ardhura të padeklaruara, mungesë dokumentacioni, të punësuar, të vetëpunësuar, me automjet, pension etj.) duke dhënë shpjegime për to.

- emrat e familjeve që futen për herë të parë duke shpjeguar arsyet;
- emrat e familjeve që rifuten në skemë duke shpjeguar arsyet;
- emrat e familjeve që janë anëtarë të skemës së ndihmës ekonomike.

3. Projektvendimi duhet të shoqërohet me relacionin përkatës, si dhe duhet të nënshkruhet nga përgjegjësi i seksionit të ndihmës dhe administratori.

4. Vendimi me numër, datë, bashkë me listat bashkëngjitur do t'u jepet:

- një kopje për zyrën e ndihmës ekonomike;
- një kopje për këshillin e bashkisë/komunës;
- një kopje për zyrën rajonale;
- një kopje për seksionin e financës.

5. Vendimi do të përmbajë:

- Nr. rendor, emrin, mbiemrin e kryefamiljarit, nr. e dosjes, nr. e frymëve, llojin e ndihmës ekonomike, e plotë apo e pjesshme, periudha e përfitimit si dhe masa e ndihmës;

- emrat e pretenduesve që nuk përfitojnë ndihmë ekonomike për arsye të caktuara (si gjendje e mirë ekonomike, të ardhura të padeklaruara, mungesë dokumentacioni, të punësuar, të vetëpunësuar, me automjet, pension) duke shpjeguar arsyet përkatëse;

- emrat e familjeve që futen për herë të parë, duke shpjeguar arsyet;
- emrat e familjeve që rifuten në skemë, duke shpjeguar arsyet;
- emrat e familjeve që janë anëtarë të skemës së ndihmës ekonomike.

6. Vendimi do të zbardhet nga këshilli i bashkisë a komunës dhe do të nënshkruhet nga sekretari dhe kryetari i këshillit të bashkisë ose komunës.

7. Borderoja hartohet nga seksioni i financës pranë bashkisë a komunës në dy kopje ku:

- një kopje e mban zyra e ndihmës ekonomike;
- një kopje seksioni i financës.

Borderoja do të përmbajë:

- nr. rendor, emrin, mbiemrin e kryefamiljarit, nr. e dosjes, nr. e frymëve, llojin e ndihmës ekonomike, e plotë apo e pjesshme, periudha e përfitimit, si dhe masa e ndihmës (shih formularin bashkëngjitur).

Borderoja do të ketë vendimin bashkëngjitur, ajo do të nënshkruhet nga llogaritari dhe përgjegjësi i financës pranë bashkisë ose komunës.

8. Regjistri hartohet nga administratorët e seksionit të ndihmës ekonomike pranë bashkisë a komunës. Në regjistër hidhen të gjitha të dhënat analitike për çdo përfitues të ndihmës ekonomike, si: nr. rendor, emrin, mbiemrin e kryefamiljarit, nr. e dosjes, nr. e frymëve i ndarë kryefamiljar, në moshë pune, nën moshë pune, mbi moshë dhe të paafte fizik e mendor, sipërfaqja e tokës, kategoria e saj, të ardhurat nga toka, pensionet, të ardhurat nga blegtoria, pemëtari, vreshta e ullinj, bletë, të ardhura të tjera, shuma e të ardhurave, masa e plotë ndihmëse, diferenca e masës së plotë me të pjesshmen, periudha sipas muajve, si dhe shuma (shih formularin bashkëngjitur).

9. Drejtoria rajonale organizon takime, seminare, si dhe organizon kualifikimin personal të administratorëve pranë seksioneve të ndihmës ekonomike në bashki a komunë.

10. Administratorët e seksionit të ndihmës dhe të perkujdesit në bashki/komuna janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit, si dhe raportojnë përpara këshillit të komunës, si dhe kryetarit të bashkisë/komunës.

11. Administratori duhet të verifikojë gjendjen social-ekonomike të familjes pretenduese për ndihmë, nëpërmjet intervistimit në zyrë ose verifikimit në shtëpinë e tyre. Fleta e verifikimit plotësohet nga administratori dhe është pjesë përbërëse e dosjes për familjet e skemës (bashkëngjitur formulari i verifikimit).

12. Administratori shoqëror harton kërkesën për bllokndihmën ekonomike një herë në 4 muaj dhe e dërgon atë pranë zyrave rajonale, ku bëhet përmbledhja, dhe bashkë me kërkesat

dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (sipas formularit bashkëngjitur).

13. Seksionet e ndihmës ekonomike pranë komunave nga data 1 deri 15 të çdo muaji bëjnë pranimin e dokumentacionit të familjeve që pretendojnë të përfitojnë ndihmë ekonomike.

14. Nga 15 deri 25 verifikon nga pikëpamja ligjore dhe nga pikëpamja e përputhjes me realitetin të gjithë dokumentacionin e grumbulluar. Gjatë kësaj kohe hartohen listat, relacioni përmbledhës, së bashku me projektvendimin dhe dërgohet në këshillin e bashkisë a komunës.

15. Brenda muajit, këshillat e bashkive/komunave marrin vendimin përkatës për dhënien e ndihmës ekonomike.

16. Çdo njësi administrative, bashkie a komune të afishojë çdo muaj listat me emrat e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe masën e përfitimit për muajin në qendrën e njësisë administrative.

17. Ndihma ekonomike e familjes përfituese tërhiqet nga kryefamiljari me dokument identiteti.

18. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimet nr.927/3 dhe nr.927/4, datë 31.05.2002, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
KOMUNA _____

Data

V Ë R T E T I M

Vërtetojmë se familja (emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit), me numër dosje _____ është trajtuar me ndihmë ekonomike nga bashkia (komuna) jonë nga data _____ deri në datën _____

Familja ka pasur _____ (numri) anëtarë (emri, atësia, mbiemri)

Masa e ndihmës ekonomike që ka përfituar familja _____ (shuma në lekë/një muaj), ndihmë e plotë ose e pjesshme.

Në bazë të certifikatës me numër _____, kjo familje transferohet në bashkinë (komunën) _____.

Administratori shoqëror

Kryetari

Në bazë të verifikimit të bërë, konfirmoj vërtetësinë e informacionit të paraqitur më sipër nga bashkia/komuna.

Drejtori i zyrës rajonale

Bashkia _____

Komuna _____

Datë _____

Lista e personave për t'u verifikuar për ndihmë ekonomike

r.	Emri, atësia, mbiemri	Nu mri i dosjes	a Datëlindj	Adresa e banimit	Konfirmi mi i institucionit

Prefektura _____
Rrethi _____
Bashkia, komuna _____

PROJEKTVENDIM

NR _____ DATË _____

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1- 31. .200.....

Duke u mbështetur në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, vendimin nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike” dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, administratorët e seksionit të ndihmës sociale i propozojnë këshillit të bashkisë/komunës se gjatë muajit _____ pranë seksionit të ndihmës ekonomike paraqiten kërkesë _____ familje.

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera, konkludojmë dhe propozoj se:

Përfitojnë ndihmë ekonomike _____ familje me një fond _____ lekë. Nga këto, me ndihmë të plotë _____ familje me një fond _____ lekë dhe me ndihmë të pjesshme _____ familje me një fond _____ lekë.

Përfitojnë pagesë paaftësie në total _____ persona me një fond _____ lekë.

Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike _____ familjet, për arsyet e renditura përbri.
Emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit _____ Arsytet e daljes nga skema

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Emrat e familjeve që futen për herë të parë në skemën e ndihmës ekonomike dhe arsyet përkatëse.

Emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit _____ Arsytet e hyrjes në skemë

1. _____
2. _____
3. _____

Emrat e familjeve që rifuten në skemën e ndihmës ekonomike dhe arsyet përkatëse.

Emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit _____ Arsytet e hyrjes në skemë

1. _____
2. _____
3. _____

SEKRETARI I NDIHMËS EKONOMIKE

Shefi i ndihmës ekonomike
Emri, atësia, mbiemri, firma
firma

Administratorët shoqërorë
Emri, atësia, mbiemri,

Prefektura _____
 Rrethi _____
 Bashkia, komuna _____

**LISTA QË I BASHKËNGJITET PROJEKTVENDIMIT NË TOTAL TË FAMILJEVE NË SKEMËN
 E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUdhËN E AKORDUAR**

r.	N	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i dosje ve	Nr. i frym ëve	Lloji i ndihmës	Shu ma përfituese
	1					
	2					
	3					
	4					
	5					
	6					
	7					
	8					
	9					
0	1					

Shefi i ndihmës ekonomike
 Emri, atësia, mbiemri, firma

Administratorët shoqërorë
 Emri, atësia, mbiemri, firma

Prefektura _____
Rrethi _____
Bashkia, komuna _____

VENDIM

NR. _____ DATE _____

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1- 31. .200.....

Duke u mbështetur në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, vendimin nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, udhëzimeve në zbatim të tyre, si dhe në bazë të projektvendimit të paraqitur nga administratorët e seksionit të ndihmës sociale, këshilli i bashkisë/komunës

VENDOSI:

Të përfitojnë ndihmë ekonomike _____ familje me një fond _____ lekë. Nga këto me ndihmë të plotë _____ familje me një fond _____ lekë dhe me ndihmë të pjesshme _____ familje me një fond _____ lekë.

Të përfitojnë pagesë paaftësie në total _____ persona me një fond _____ lekë.

Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike _____ familjet, për arsyet e renditura përbri.
Emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit _____ Arsytet e daljes nga skema

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Emrat e familjeve që futen për herë të parë në skemën e ndihmës ekonomike dhe arsyet përkatëse.

Emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit _____ Arsytet e hyrjes në skemë

1. _____
2. _____
3. _____

Emrat e familjeve që rifuten në skemën e ndihmës ekonomike dhe arsyet përkatëse.

Emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit _____ Arsytet e hyrjes në skemë

1. _____
2. _____
3. _____

Sekretari i bashkisë/komunës

Kryetari i këshillit bashkisë/komunës

VULA

Prefektura _____
 Rrethi _____
 Bashkia, komuna _____

**LISTA QË I BASHKËNGJTET PROJEKTVENDIMIT NË TOTAL TË FAMILJEVE NË SKEMËN E
 NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIU DHËN E AKORDUAR**

r.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i dosje ve	Nr. i frymë ve	Llo ji i ndihmës	Shu ma përfituese
0					
1					
2					

Sekretari i këshillit
 Emri, atësia, mbiemri, firma

Kryetari i këshillit
 Emri, atësia, mbiemri, firma

VULA

Prefektura _____
 Rrethi _____
 Bashkia, komuna _____

BORDERO E PAGESËS SË NDIHMËS EKONOMIKE

Për

periudhën _____ 200 ____

r.	E mri, atësia, mbiemri	N r. i d osjeve	N r. i F rymëve	L loji i ndihmës	Shuma përfituese	N umri i dokumt identitetit	Nën shkrimi
0							
1							

Llogaritari
 Emri, mbiemri, firma

Shefi i financës

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA, KOMUNA _____

Date, me _____

Te dhenat plotesuese per shperndarjen e ndihmes ekonomike

Muaji _____

Nr	EMERTIMI	Numri I personave	Shuma 000/leke
1	Numri I popullesise		
2	Numri I familjeve qe trajtohen me ndihme ekonomike		
3	Te ndare sipas grup moshave		
	a. Kryefamiljar		
	b. Ne moshe		
	c. Nen moshe		
	d. mbi moshe		
4	Te ardhura gjithsej		
	a. Nga toka		
	b. Nga blegtoria		
	c. Nga pensionet		
	d. Te tjera		
5	Nenat me shume femije(numri femijeve)		
6	Numri I jetimeve		

ADMINISTRATORI

KRYETARI

VULA

Republika e Shqipërisë

Bashkia

Komuna

Datë

TË DHËNA MBI VIZITËN NË FAMILJE

Kryefamiljari _____ nr.dosjes _____

nr.anëtarëve _____ lloji i ndihmës: e plotë ☐ e pjesshme ☐

Koha e fillimit të trajtimit me ndihmë ekonomike ☐☐ ☐☐☐☐

qëndrueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike: pa ndërprerje ☐

me ndërprerje ☐

radha e vizitës _____

personi me të cilin u krye intervista _____

adresa e banimit _____

tipi i banesës: pallat ☐ shtëpi përdhese ☐ vilë ☐ barakë ☐

kontrata e banesës: tapi ☐ pa privatizuar ☐ me qira ☐

me kredi ☐ pa kontratë ☐

banesë më vete ☐ banesë e përbashkët _____ banesë jo e tija ☐

numri i të ndarave: 1 ☐ 1 + 1 ☐ 2 + 1 ☐ 3 + 1 ☐

konforti i banesës:

kuzhina _____

dhomat _____

salloni _____

banjo _____

oborri _____

modifikime të banesës, përdorime për qëllime të tjera:

kryen investime në banesë: po ☐ jo ☐

prona dhe pasuri të tjera: _____

* gjendja shëndetësore e antarëve të familjes: _____

* probleme sociale dhe shtëpiake të familjes: _____

* krahasimi me deklaratat e kryefamiljarit:
përputhet ☐ përputhet pjesërisht ☐ nuk përputhet ☐

* ndryshime me vizitën paraardhëse:
s'ka ndryshime ☐ ka ndryshime ☐ _____

- * mendimi i grupit të verifikimit:
- ☐ të trajtohet në mënyrë të zakonshme
 - ☐ të trajtohet në mënyrë të diferencuar
 - ☐ të trajtohet duke e afruar në nivelin maksimal
 - ☐ ti ndërpritet ndihma ekonomike
 - ☐ ti ndërpritet ndihma ekonomike dhe të kthejë lekët
 - ☐ ti ndërpritet ndihma ekonomike dhe të gjobitet me _____ fish
 - ☐ të rifutet në skemën e ndihmës ekonomike

* klasifikimi i gjendjes së familjes: A B C D

antarë të familjes	grupi i verifikimit
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË

PËR VERTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit _____ Zona Kadastrale Nr. _____
Numri i Pasurisë _____ Volumi _____ Faqe _____
Adresa e Pasurisë _____
Lloji i Pasurisë _____
Sipërfaqja Totale _____
Nga kjo : Sa Trusht _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
Nga pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zot (Zotërinjtë)

Emri	Atësis	Mbiemri	Pjesa	Adresa
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____

është pronar i _____
janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
është përfqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
konizimet e pasurisë janë : V _____ L _____ J _____ P _____

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
në datë _____ Nr. _____

Data e lëshimit të certifikatës

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUES

UDHËZIM
Nr.497, datë 6.3.2006

PËR LLOGARITJEN E TË ARDHURAVE QË SIGUROHEN NGA PRODHIMI BUJQËSOR DHE BLEGTORAL

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, si dhe në zbatim të pikave 4, 11/b, 22/ç, d dhe 38 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta,

UDHËZOJNË:

1. Të ardhurat nga toka (sipas kategorive të saj që sigurohen nga bimët e arave, vreshtat, ullishtet, pemëtaria, me përjashtim të tokës në proces shkripëzimi), llogariten sipas koeficientëve të mëposhtëm:

Emërtimi	Kategoritë e tokës								
Koeficientët e të ardhurave lekë/m ² në vit	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX-X
	9	8	7	7	5	5	4	4	3

Shembull: Mënyra e llogaritjes së të ardhurave nga toka është:

Supozojmë se familja pretenduese për ndihmë ekonomike përbëhet nga 5 persona dhe ka në pronësi 10 000 m² (1 ha) tokë të kategorisë X siç përcaktohet në tabelën e mësipërme. E ardhura që siguron kjo familje llogaritet 30 000 lekë në vit ose 2 500 lekë në muaj (10 000 m² x 3 lekë/m²).

2. Në kuptim të pikës 11/b të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike” konsiderohet “tokë e zënë e dikujt tjetër” edhe sipërfaqja e tokës bujqësore që e posedojnë dhe e shfrytëzojnë familjet bujqësore, por që nuk kanë pranuar ose kanë refuzuar të firmosin aktin e marrjes së tokës në pronësi, të lëshuar nga komisioni i tokës sipas dispozitave të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

3. Administratorët shoqërorë në bashki/komuna kërkojnë pranë seksioneve të administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark (SAMT) të dhëna për kategoritë e tokës bujqësore sipas studimit të bonitetit.

4. Sipërfaqja e tokës që nevojitet për mbajtjen e një lope është 0.5 ha. Familja fshatare që disponon bagëti mbi këtë kufi i llogariten të ardhurat si nga prodhimi bujqësor për sipërfaqen e tokës në pronësi ose në përdorim, si dhe të ardhurat që sigurohen nga mbajtja e bagëtive mbi kufirin e caktuar më lart.

Shembull: Mënyra e llogaritjes së të ardhurave nga mbajtja e bagëtive mbi kufirin e caktuar do të jetë:

Familja pretenduese për ndihmë ekonomike që përbëhet nga 5 anëtarë, disponon 1 ha tokë dhe 3 lopë. Familja i përket zonës malore.

Toka është e kategorisë së X dhe ka koeficientin 3 lekë/m² sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

Në këtë rast të ardhurat llogariten si më poshtë:

a) Të ardhurat nga toka do të jenë 30 000 lekë në vit ose 2500 lekë në muaj (10 000 m² x 3 lekë/m²);

b) Mundësia e mbajtjes së bagëtisë në sipërfaqen që disponon fermeri është:

Fermeri me sipërfaqen e tokës që disponon mund të mbajë 2 lopë (1 ha që disponon fermeri pjesëtohet me koeficientin 0.5 (sipërfaqja e nevojshme për 1 lopë).

Sipas kësaj llogaritjeje, familja disponon 1 lopë më shumë sesa kufiri mbi të cilin llogariten të ardhurat.

5. Të ardhurat nga blegtoria llogariten të diferencuara, sipas zonave dhe koeficientëve të mëposhtëm:

a) Në zonat fushore:

Të ardhurat nga 1 lopë=15 dele/dhi=3 dosa=5 gica=20 zgjoje bletësh=22.500 lekë/vit=1.875 lekë në muaj.

b) Në zonat kodrinore:

Të ardhurat nga 1 lopë=12 dele/dhi=3 dosa=5 gica=20 zgjoje bletësh=18.000 lekë/vit=500 lekë në muaj.

c) Në zonat malore:

Të ardhurat nga 1 lopë=10 dele/dhi=3 dosa=5 gica=20 zgjoje bletësh=13.000 lekë/vit=1.083 lekë në muaj.

6. Masa e ndihmës ekonomike mujore e pjesshme, për familjet e përcaktura sipas kreut I, pika 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, llogaritet si diferencë ndërmjet masës së ndihmës ekonomike të plotë në përputhje me strukturën e familjes dhe të ardhurat mujore që llogariten sipas pikave 1 dhe 5 të këtij udhëzimi.

Shembull: Masa e ndihmës ekonomike mujore dhe mënyra e llogaritjes së saj për këtë familje me 5 anëtarë: (kryefamiljari, 2 anëtarë në moshë pune dhe 2 anëtarë nën moshë pune) do të jetë 5 200 lekë në muaj si më poshtë:

- kryefamiljari përfiton 2600 lekë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.7897, datë 14.12.2005;

- 2 anëtarët në moshë pune përfitojnë 1200 lekë (2x600 lekë);

- 2 anëtarë nën moshë pune përfitojnë 1400 lekë (2x700 lekë);

- të ardhurat nga toka dhe bagëti 3 583 lekë në muaj (2500+1083);

- të ardhurat nga toka, siç u përcaktua në pikën 1 të këtij udhëzimi, janë 2500 lekë në muaj.

- të ardhurat për lopë që ka fermeri mbi kufirin e mundshëm që u përcaktua në pikën 4 të këtij udhëzimi llogariten 1 083 lekë në muaj.

Pra fermerit i takon të përfitojë ndihmë ekonomike mujore (të pjesshme) në masën 1617 lekë (5200-3583).

7. Udhëzimi nr.10, datë 16.3.1994 “Mbi rishikimin e të ardhurave që siguron familja fshatare nga prodhimi bujqësor dhe blegtoral, “Shtesa e udhëzimit nr.10, datë 13.6.1994, udhëzimi nr.16, datë 9.5.1995 “Mbi disa ndryshime në udhëzimin nr.10, datë 16.3.1994 dhe shtesës së udhëzimit nr.10, datë 13.6.1994 në lidhje me llogaritjen e të ardhurave nga blegtoria”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

UDHËZIM **Nr.1956, datë 19.9.2006**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA NR.1281, DATË 15.7.2004 “PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR.1766/1, DATË 17.9.2003 “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR.277, DATË 18.6.1997 “PËR PËRFITIMIN NGA STATUSI I TË VERBËRIT””
(I NDRYSHUAR)”**

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.245, datë 27.4.2006 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.1766/1, datë 17.9.2003 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimin nga statusi i të verbërit” (i ndryshuar), bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2 të udhëzimit, kudo ku përdoret shprehja “...6800 lekë në muaj...” zëvendësohet me shprehjen “...është 8000 lekë në muaj...”.

2. Në pikën 3 të udhëzimit, shprehja "...prej 13 600 lekë në muaj (2 x 6800 lekë)...", zëvendësohet me shprehjen "...është 16 500 lekë në muaj...".

3. Në pikën 4 dhe 5 të udhëzimit, shprehja "...përkatësisht 20 400 lekë në muaj (3x6800 lekë) zëvendësohet me shprehjen "përkatësisht 24 800 lekë në muaj...".

4. Në pikën 6 të udhëzimit, shprehja "është 10 200 lekë në muaj (150% 6800)" zëvendësohet me shprehjen "12 000 lekë në muaj".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.9.2006.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

UDHËZIM
Nr.1957, datë 19.9.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.619, DATË 7.9.2006
"PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR"

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.619, datë 7.9.2006 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.31, datë 20.1.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.245, datë 27.4.2006 "Për përcaktimin e pagës minimale për vitin 2006",

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 1 germa "b" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.619, datë 7.9.2006 është 8000 (tetë mijë) lekë në muaj.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektin nga 1.9.2006.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

UDHËZIM
Nr.1959, datë 19.9.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.618, DATË 7.9.2006
"PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË
PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR"

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", në zbatim të pikës 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 7.9.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.245, datë 27.4.2006 "Për përcaktimin e pagës minimale për vitin 2006",

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 7.9.2006, është 8000 (tetë mijë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 9.9.2006, është 16 500 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 9.9.2006, është 24 800 (njëzet e katër mijë e tetëqind) lekë në muaj.

4. Masa e kujdestarit të personit me aftësi të kufizuar, e përcaktuar sipas pikës 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 9.9.2006, është 8000 (tetë mijë) lekë në muaj.

5. Masa e kujdestarit, e përcaktuar sipas pikës 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 9.9.2006, është 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektin nga 1.9.2006.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

MARRËVESHJE NDËRINSTITUCIONALE BASHKËPUNIMI

PËR MONITORIMIN E FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Sot, në datën 25.10.2006, midis Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të quajtura Palë këtu dhe më poshtë, në bazë dhe për zbatim të nenit 142 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003, i ndryshuar, nënshkruhet kjo Marrëveshje bashkëpunimi.

Palët në këtë Marrëveshje bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është angazhimi i Palëve, në përputhje me detyrimet përkatëse kushtetuese dhe ligjore, për përcaktimin e rregullave, për shfrytëzimin e kapaciteteve teknike të KKRT-së, për nevojat e monitorimit të fushatës zgjedhore, në radion dhe televizionin publik dhe privat, në funksion të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Neni 2

Palët në këtë Marrëveshje bashkëpunimi veprojnë në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit merr përsipër:

- a) Të vërë në dispozicion të Bordit të Monitorimit të Medias (BMM) pajisjet teknike për monitorim.
- b) Të vërë në dispozicion të BMM ambiente të mjaftueshme për kryerjen e monitorimit.
- c) Të vërë në dispozicion të BMM studion e monitorimit dhe personelin teknik përkatës.

Neni 4

KQZ-ja merr përsipër shpenzimet financiare për pagesën e personelit që do të angazhohet për monitorim.

Neni 5

KKRT-ja merr përsipër të bëjë regjistrimin e sinjalit në mënyrë dixhitale deri në 15 operatorë radiotelevizivë.

Neni 6

Për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga kjo Marrëveshje, Palët veprojnë në bazë të kompetencave që u njeh ligji. Në këtë kuadër, KKRT-ja njeh rolin drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për monitorimin e operatorëve radiotelevizivë, në nivel kombëtar dhe vendor, dhe angazhohet për realizimin e detyrave që burojnë nga kjo Marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 7

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, 25.10.2006

**PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË RADIOS
DHE TELEVISIONIT
KRYETARI
Ledi Bianku**

**PËR KOMISIONIN QENDROR TË
ZGJEDHJEVE
KRYETARI
Çlirim Gjata**

UDHËZIM Nr.7, datë 20.10.2006

PËR ADMINISTRIMIN E MATERIALEVE ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29, pika 1, nenit 93, nenit 93/1, nenit 109/2, nenit 109/3, neni 109/7, pika 6 dhe nenit 158 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

PJESA I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për përgatitjen dhe administrimin e materialeve zgjedhore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në Komisionin e Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore (KZQV), në Komisionin e Qendrës së Votimit (KQV) dhe ndërmjet tyre, para, gjatë dhe pas zgjedhjeve.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Në kuptim të këtij udhëzimi, materiale zgjedhore quhen të gjitha materialet, të cilat do të përdoren nga administrata zgjedhore në funksion të procesit zgjedhor.

2. Materialet zgjedhore grupohen në dokumentacion zgjedhor, materiale zgjedhore të inventarizuara dhe materiale të përgjithshme zgjedhore.

Neni 3

Struktura përgjegjëse

1. Materialet zgjedhore përgatiten nga Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore, në bashkëpunim me pjesën tjetër të administratës së KQZ-së, sipas procedurave që përcakton ky udhëzim dhe aktet e tjera të KQZ-së.

2. Materialet zgjedhore merren në dorëzim nga Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore në përputhje me aktet e KQZ-së.

PJESA II

PËRGATITJA E MATERIALEVE ZGJEDHORE PËR FILLIMIN E PUNËS SË KZQV-SË

Neni 4

Materialet zgjedhore për fillimin e punës së KZQV-ve

1. Pas ngritjes së komisioneve të zgjedhjeve për qeverisjen vendore (KZQV), Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore përgatit materialet zgjedhore për fillimin e punës së KZQV-ve. Dorëzimi i materialeve zgjedhore, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me procesverbal model PV – KZQV – 01. Transporti i materialeve zgjedhore për fillimin e punës për KZQV-të, bëhet nga administrata e KQZ.

2. Skema e transportit dhe e dorëzimit përgatitet nga Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore dhe u njoftohet menjëherë anëtarëve të KQZ-së.

3. Materialet zgjedhore për fillimin e punës së KZQV-së, të përgatitura sipas pikës 1 të këtij neni, i dorëzohen si rregull KZQV-së.

Neni 5

Materialet zgjedhore që shërbejnë për informim dhe edukim

Materialet zgjedhore që shërbejnë për informim dhe edukim, u dorëzohen zyrtarëve rajonale zgjedhore në çdo qark. Inspektorët rajonalë marrin masat për dorëzimin KZQV-ve të artikujve promocionalë, sipas grafikut të shpërndarjes, të dërguar nga KQZ-ja.

PJESA III

PËRGATITJA E MATERIALEVE ZGJEDHORE PËR KZQV-TË, GN-TË DHE KQV-TË

Neni 6

Materialet zgjedhore për KZQV-të

1. Materialet e inventarizuara dhe dokumentacioni zgjedhor merren në dorëzim nga KZQV-ja me procesverbal model PV - KZQV – 02.

2. Materialet e përgjithshme zgjedhore organizohen në një paketë të vetme të mbyllur, të cilat dorëzohen në KZQV. Lista e materialeve që ndodhen brenda paketës verifikohet sipas inventarit vetëm pas hapjes së saj.

3. Të gjitha materialet zgjedhore për çdo KZQV paketohen në kuti të veçanta ambalazhi, në të cilat shënohet emri i KZQV-së përkatëse.

Neni 7

Materialet zgjedhore për GN-të

Materialet zgjedhore për grupet e numërimit përfshihen në kutinë e materialeve të KZQV-së. Materialet që i dërgohen KZQV-së për grupet e numërimit përcaktohen sipas një inventari bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 8

Materialet zgjedhore për KQV-të

1. Materialet zgjedhore për çdo KQV paketohen në kuti të veçanta ambalazhi, ku përfshihen kutitë e votimit, kutia e materialeve zgjedhore dhe kanë të shënuar emrin e KZQV-së dhe numrin e KQV-së.

2. Materialet e përgjithshme zgjedhore organizohen në një paketë të vetme të mbyllur, brenda së cilës futet lista e detajuar (inventar) e materialeve që ndodhen brenda paketës.

3. Kutitë e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore do të jenë të identifikueshme me etiketa të veçanta.

PJESA IV
DORËZIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE

Neni 9
Mënyra e shpërndarjes së materialeve zgjedhore

1. Skema e shpërndarjes së materialeve zgjedhore përgatitet nga Drejtoria e Logjistikës dhe u njoftohet anëtarëve të KQZ-së.

2. Materialet zgjedhore shoqërohen në çdo KZQV nga një punonjës i KQZ-së. Punonjësi i KQZ-së merr në dorëzim materialet zgjedhore për komisionet e zgjedhjeve për qeverisjen vendore përkatëse, sipas skemës së shpërndarjes.

3. Punonjësi i KQZ-së merr në dorëzim nga DLZ materialet zgjedhore me procesverbalet sipas modeleve dhe specifikimeve të përcaktuara në lidhjet përkatëse bashkëlidhur këtij udhëzimi, si më poshtë:

- a) PV - KZQV - 02 , për materialet zgjedhore për KZQV-në;
- b) PV - KZQV - 03, për materialet zgjedhore për KQV-të;
- c) PV - KZQV - 04, për fletët e votimit.

Neni 10
Dorëzimi i materialeve zgjedhore në KZQV

1. Materialet zgjedhore për KZQV-në, GN-të dhe KQV-të i dorëzohen si rregull kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KZQV-së. Në rastet e pamundësisë së paraqitjes të tre personave të sipërpërmendur, punonjësi i KQZ-së mund t'ua dorëzojë materialet zgjedhore dy anëtarëve, me kusht që t'i përkasin spektrit të kundërt politik.

2. Në momentin që KZQV-ja merr në dorëzim materialet zgjedhore, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari, në prezencë të KZQV-së, hapin në fillim kutinë e materialeve zgjedhore për KZQV-në dhe verifikojnë listën e inventarit bashkëlidhur procesverbalit që ndodhet brenda kutisë për KZQV-në.

PJESA V
ADMINISTRIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KZQV-JA

Neni 11
Dorëzimi i materialeve zgjedhore nga KZQV-ja për KQV-të

1. Kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZQV-së bëjnë dorëzimin e materialeve zgjedhore për çdo KQV, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 93/1 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar.

2. Materialet zgjedhore për çdo KQV merren në dorëzim nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KQV-së , sipas procesverbalit model PV- KQV-05, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Çdo anëtar i KQV-së që dëshiron, mund të jetë prezent.

3. Vulat metalike me kodet e sigurisë për kutitë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore i dorëzohen KQV-së me procesverbalin model PV-KQV-06, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Kryetari i KQV-së, me zgjedhje rastësore, merr vulën e kryetarit të KQV-së, gris ambalazhin e vulës dhe pasi vulos modelin krahasues të vulës, në një fletë të bardhë shënon emër, mbiemër dhe firmos në prani të anëtarëve të KZQV-së.

Neni 12
Marrja në dorëzim e kutive të votimit dhe e materialeve zgjedhore nga KZQV-ja pas mbylljes së votimit

1. Pas mbylljes së procesit të votimit, KZQV-ja organizon në vendin e numërimit të votave grupet e pritjes së kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore me jo më pak se 2 anëtarë të saj, me përkatësi të kundërt politike.

2. Gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore, grupi i marrjes në dorëzim në fillim merr dhe verifikon kutitë me fletët e votimit dhe ndjek këto procedura:

a) Shënon në procesverbalin e marrjes në dorëzim, model PV - KZQV- 09, numrat e kodeve të sigurisë, me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit.

b) Verifikon në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë së vulave, me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit, sipas procesverbalit të dorëzimit të kodeve të sigurisë PV – KZQV - 06, të mbajtur nga KZQV-ja për këtë qendër votimi;

c) Në rast se gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit, grupi i marrjes në dorëzim konstaton se:

- mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode të sigurisë;
- vendosja e vulave me kodet e sigurisë është bërë në mënyrë të tillë që lejon ndërhyrje ndërmjet kutisë dhe kapakut të saj;

- kutia ka në trupin ose në kapakun e saj thyerje ose çarje, që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materiali tjetër të votimit;

- kutia është e ndryshme nga lloji, forma dhe përmasat e miratuara dhe dërguara nga KQZ-ja, atëherë grupi i marrjes në dorëzim shënon në PV-në e marrjes në dorëzim parregullsinë e konstatuar, sipas pikave b dhe c, dhe informon menjëherë KZQV-në dhe i kërkon asaj të bëjë vlerësimin e kutisë.

d) KZQV-ja, pasi vlerëson rastin, merr vendim, i cili shënohet në procesverbalin e konstatimit. Nëse kutia vlerësohet e parregullt, asaj i vendoset etiketa “KUTI E PARREGULLT”. Nëse kutia vlerësohet si e rregullt, grupi i marrjes në dorëzim vazhdon më tej procesin.

e) KZQV-ja shënon mospërputhjet e konstatuara në procesverbalin e marrjes në dorëzim PV – KZQV – 09, bashkëlidhur këtij udhëzimi, si dhe në librin e protokollit.

3. Kutia e vlerësuar si e parregullt, vendoset në vendin e veçantë të caktuar për “KUTITE E PARREGULLTA”, dhe nuk i nënshtrohet procedurave të numërimit nga grupi i numërimit të votave.

4. Kutitë e votimit të vlerësuara si KUTI TË PARREGULLTA, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, nuk merren më në shqyrtim dhe nuk hapen nga KZQV-ja.

5. Në rastet kur kutia e materialeve zgjedhore vlerësohet si “E PARREGULLT”, atëherë ajo i nënshtrohet procedurave të përcaktuara në nenin 109/3 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar.

6. Procesverbali i marrjes në dorëzim nga KZQV-ja, PV-KZQV-09, firmoset nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari i KQV-së. Punonjësi i Policisë firmos në këtë procesverbal vetëm për shoqërimin, garantimin dhe mosprekjen e kutive të votimit nga qendra e votimit në vendin e numërimit të votave.

7. Një kopje e procesverbalit të marrjes në dorëzim PV- KZQV-09 i jepet KQV-së, një kopje i dorëzohet policit shoqërues, një kopje dorëzohet në KQZ, kurse kopja origjinale administrohet nga KZQV-ja.

PJESA VI

PRITJA E DOKUMENTACIONIT DHE E MATERIALEVE ZGJEDHORE NË KQZ

Neni 13

Dorëzimi i tabelave të rezultateve, kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore

1. Menjëherë pas përfundimit të procedurave të nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZQV-së dorëzon në KQZ: tabelat origjinale përmbledhëse të rezultateve, model 39-06/07 dhe 40-06/07, tabelat origjinale të rezultateve të grupeve të numërimit model 56-06/07 dhe 57-06/07, procesverbalin e marrjes në dorëzim të KZQV-së, procesverbalin e konstatimit, librin e protokollit të mbledhjeve, vulën e KZQV-së, kutitë e votimit me fletët e votimit, kutitë e materialeve zgjedhore, materialet zgjedhore të inventarizuara, si dhe çdo dokument tjetër zgjedhor.

2. KQZ-ja organizon grupet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore me jo më pak se 2 persona të administratës së KQZ-së të autorizuar nga titullari i institucionit.

3. Dorëzimi i materialeve zgjedhore të inventarizuara bëhet me procesverbal KZQV- PV- 11, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore dorëzohen me procesverbal model PV – KZQV-13, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Tabelat origjinale përmbledhëse të rezultateve, së bashku me tabelat e rezultateve të grupeve të numërimit, procesverbalin e marrjes në dorëzim të KZQV-së procesverbalit të konstatimit, librit të protokollit dhe vula e KZQV-së dorëzohen veçmas me procesverbal PV-KZQV-12, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Tabelat origjinale përmbledhëse të rezultateve, tabelat e rezultateve të grupeve të numërimit, libri i protokollit, procesverbali i konstatimit, si dhe kopjet origjinale të procesverbaleve të dorëzimit të tyre në KQZ, depozitohen në zyrën e regjistrimit të akteve dhe dokumentacionit.

Neni 14

Administrimi i kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, në rast të hetimit administrativ në KQZ

Në rast se, për nevojat të hetimit administrativ, kutitë e votimit apo të materialeve zgjedhore hapen, rimbyllja e tyre bëhet me anë të procesverbalit PV-KQZ-14, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 15

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Ç.Gjata Kryetar

F.Çato Zëvendëskryetar

Anëtarë: A. Ristani, D.Subashi, D.Prenga, F.Kumbaro, K.Zguri

UDHËZIM

Nr.8, datë 30.10.2006

**PËR PROCEDURAT E AKREDITIMIT DHE RREGULLAT E VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE NGA ORGANIZATAT JOQEVERITARE,
SHQIPTARE DHE TË HUAJA, ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE, PËRFAQËSUES TË
SHTETEVE TË HUAJA DHE MEDIAVE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të neneve 18, 19 dhe 29, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

PJESA I

QËLLIMI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim përcakton rregullat për akreditimin, vëzhgimin e procesit zgjedhor, të drejtat dhe detyrat, kritere dhe standarde për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore nga:

- organizatat joqeveritare, shqiptare dhe të huaja;
- organizatat ndërkombëtare;
- përfaqësues të shteteve të huaja;
- përfaqësues të mediave.

Neni 2
Kushtet për të qenë vëzhgues

1. Vëzhguesi duhet të propozohet nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 1.
2. Vëzhguesi duhet të plotësojë kushtet për të qenë zgjedhës, si dhe të jetë i padënuar penalisht.

Neni 3
Mandati i vëzhguesve

1. Vëzhguesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me afatet e përcaktuara në autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja.
2. Vëzhgues afatgjatë konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin 45 ditë para zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
3. Vëzhgues afatshkurtër konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin nga 72 orë para datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit nga KZQV-ja.

PJESA II
PROCEDURA PËR CAKTIMIN E VËZHguesVE

Neni 4
Kërkesa për akreditim

Subjektet e përcaktuara në këtë udhëzim, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të paraqesin pranë KQZ-së dokumentacionin si më poshtë:

a) kërkesë nga drejtuesi apo përfaqësuesi i subjektit që kërkon të vëzhgojë procesin zgjedhor, e cila duhet të përmbajë edhe:

- adresën;
- numrin e telefonit;
- informacione të tjera për kontaktim;

b) vërtetimin e regjistrimit në gjykatë ose në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe/ose ftesën përkatëse;

c) lista të veçanta për:

- vëzhguesit afatgjatë (model nr.01-LV);
- vëzhguesit afatshkurtër (model nr.02-LV);
- përkthyesit e propozuar (model nr.03-LP).

Kërkesa për akreditim dhe listat e vëzhguesve sipas pikës c paraqiten me shkrim. Kopje të listave në formë elektronike, në programin EXCEL, sipas modeleve nr.01-LV, 02-LV dhe 03-LP bashkëlidhur me këtë udhëzim, duhet të përfshihen me kërkesën e subjektit.

Neni 5
Përgjegjësitë e subjekteve vëzhguese

Subjektet që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, janë përgjegjëse:

- a) për saktësinë e dokumentacionit të paraqitur;
- b) për saktësinë e të dhënave personale të paraqitura për secilin prej vëzhguesve të propozuar.

Subjektet vëzhguese duhet t'ua bëjnë të ditur përmbajtjen e këtij udhëzimi të gjithë vëzhguesve të tyre.

Neni 6
Afatet

1. Subjektet shqiptare, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të paraqesin kërkesat dhe dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në nenin 4 të këtij udhëzimi, jo më herët se 45 ditë dhe jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Subjektet e huaja duhet të paraqesin kërkesat dhe dokumentacionin përkatës jo më vonë se 72 orë përpara datës së zgjedhjeve.

Neni 7
E drejta e ankimit

Kundër vendimit të KQZ-së për mosdhënien ose refuzimin e akreditimit të vëzhguesve mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

PJESA III
IDENTIFIKIMI I VËZHguesVE

Neni 8
Autorizimi i vëzhguesve

1. KQZ-ja pajis çdo vëzhgues me autorizimin përkatës sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr.1, bashkëlidhur me këtë udhëzim.

2. Autorizimi është i vlefshëm për njësi zgjedhore, qendra votimi apo vend numërimi të votave sipas shënimit në autorizimin përkatës dhe i jep vëzhguesit të drejtën të hyjë dhe të qëndrojë në ambientet e tyre duke respektuar të drejtat dhe detyrat që u njeh Kodi Zgjedhor, ky udhëzim, si dhe akte të tjera nënligjore të KQZ-së.

3. Autorizimi tregon edhe afatin e vlefshmërisë.

Neni 9
Prezantimi i vëzhguesve

1. Vëzhguesit kanë të drejtë të qëndrojnë në KZQV, në QV dhe VNV.

2. Ata duhet të paraqiten para komisioneve zgjedhore me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja dhe një dokument identifikimi personal.

3. Sipas rastit, KZQV-ja ose KQV-ja shënon në procesverbal emrin e vëzhguesit, subjektin që ai përfaqëson, numrin e autorizimit dhe numrin e dokumentit të identifikimit.

4. Në një qendër votimi nuk mund të ketë në të njëjtën kohë më shumë se dy vëzhgues nga i njëjti subjekt vëzhgues.

5. Në vendin e numërimit të votave (VNV) nuk mund të ketë më shumë vëzhgues nga një subjekt sesa janë dhe grupet e numërimit të votave (GNV). Për një grup numërimi të votave nuk mund të ketë më shumë se një vëzhgues nga i njëjti subjekt.

6. Vëzhguesit e huaj mund të shoqërohen nga një përkthyes brenda ambienteve zgjedhore. Përkthyesi është i pajisur me autorizimin përkatës lëshuar nga KQZ-ja dhe me një dokument identifikimi personal. Përkthyesi nuk mund të hyjë i vetëm në KZQV, KQV apo në vendin e numërimit të votave.

PJESA IV
TË DREJTAT DHE DETYRAT E VËZHguesVE

Neni 10
Të drejtat e vëzhguesve

Vëzhguesit, përveç atyre të parashikuara në nenin 19, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë edhe këto të drejta:

- a) t'i drejtojnë pyetje komisionit zgjedhor, pa e penguar në veprimtarinë e tij;
- b) të vëzhgojnë pa pengesë procesin e numërimit të votave;
- c) të hyjnë dhe të dalin pa pengesa në ambientet zgjedhore.

Neni 11
Detyrat e vëzhguesve

Vëzhguesit, përveç atyre të parashikuara në nenin 19, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kanë edhe këto detyra:

- a) të mos ndërhyjnë në procesin zgjedhor, në procedurat e ditës së votimit ose në procesin e numërimit të votave, të nxjerrjes së rezultatit dhe aktivitetin e komisioneve zgjedhore;
- b) të respektojnë rregullat e etikës në ambientet zgjedhore;
- c) të mos komentojnë dhe/ose debatojnë vendimet e KQV/KZQV/GNV dhe procesin e votimit.

PJESA V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Ç.Gjata Kryetar
F.Çato Zëvendëskryetar
Anëtarë: A. Ristani, D.Subashi, D.Prenga, F.Kumbaro, K.Zguri

VENDIM
Nr.80, datë 25.10.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR TË
USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 13 pika 2 paragrafi “d” të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për dhënie e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.71, datë 11.9.2002, ndryshuar me vendimin nr.3, datë 26.1.2005, pas pikës 17.6 të saj të shtohen dispozitat e mëposhtme:

17.7 Transferimi i së drejtës së pronësisë të një aksionari indirekt në masën dhjetë për qind ose më shumë të kapitalit të bankës ose të aksioneve të saj me të drejta vote, ose në një masë të tillë që krijon mundësi të ndikojë në drejtimin a politikat e saj, bëhet vetëm pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë.

17.8 Për transferimin e së drejtës së pronësisë sipas pikës 17.7 të kësaj rregulloreje, banka duhet të kërkojë miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

17.9 Kërkesa e paraqitur në Bankën e Shqipërisë shoqërohet me dokumentacionin për aksionarin indirekt të bankës, si më poshtë:

a) për aksionarin indirekt, i cili është person juridik, kërkohet dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 4.2.1., shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj rregulloreje;

b) për aksionarin indirekt, i cili është person fizik tregtar ose individ, kërkohet dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 4.2.2 të kësaj rregulloreje;

c) për aksionarin indirekt, i cili është bankë e huaj, kërkohet dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 4.2.1 paragrafi 1 shkronja “a” dhe “b” dhe të pikës 4.2.3 paragrafi 1 shkronjat “a” dhe “b” dhe paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, si dhe pëlqimi për këtë transferim i dhënë nga autoriteti licencues dhe mbikëqyrës i vendit ku banka ka selinë dhe çdo autoritet tjetër mbikëqyrës që duhet të miratojë transaksionin (nëse ka).

Përveç dokumentacionit të kërkuar sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike, kërkesa për miratim nga Banka e Shqipërisë shoqërohet në çdo rast edhe me një kopje të noterizuar të aktmarrëveshjes së nënshkruar, midis dy subjekteve për transferimin e titujve të pronësisë mbi aksionet, të cilat krijojnë pjesëmarrje influencuese.

17.10 Banka e Shqipërisë jep miratimin ose refuzon transferimin e pjesëmarrjes influencuese të aksionarit indirekt në kapitalin aksionar të bankës jo më vonë se dy muaj nga data kur dokumentacioni është paraqitur i plotë.

17.11 Pavarësisht nga përcaktimet në paragrafin 17.9 të këtij neni, mbështetur në materialin dhe në propozimin e hartuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes dhe kur ekzistojnë vështirësi të argumentuara për sigurimin e të gjithë dokumentacionit dhe të analizave që kërkohen në paragrafin 17.9 pika “c” të këtij neni, Këshilli Mbikëqyrës mund të vendosë përjashtimin nga disa prej kërkesave të përcaktuara në paragrafin 17.9, pika “c” të këtij neni, në rastin kur kemi të bëjmë me një bankë që:

- a) e ka selinë e saj qendrore në një prej vendeve anëtare të Bashkimit Europian; dhe
- b) gëzon një reputacion të mirë në tregjet ndërkombëtare dhe një gjendje të mirë financiare sipas vlerësimeve të shoqërive të specializuara të renditjes;
- c) është marrë pëlqimi i autoriteteve të huaja mbikëqyrëse për kryerjen e transaksionit, në bazë të të cilit banka e huaj fiton pjesëmarrjen në kapitalin e bankës që vepron në Shqipëri.

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.515/1, datë 9.10.2006

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV REAL”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, i përbërë nga:

Ledi Bianku	Kryetar
Mesila Doda	Zëvendëskryetare
Alban Karapici	Anëtar
Detar Hysi	Anëtar
Frano Kulli	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti televiziv vendor “TV Real”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 dhe neni 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë RTV”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, vendimet e KKRT-së nr.440, datë 21.3.2006 “Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Real”” dhe nr.477, datë 29.6.2006 “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Real””

VËREN:

Në datën 3.1.2006 ka përfunduar afati i licencimit të subjektit televiziv vendor të licencuar “TV Real”. KKRT ka njoftuar zyrtarisht këtë subjekt në datën 11.10.2005 me shkresën nr.770 prot., duke caktuar afatin për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit për rinovimin e licencës. Njëkohësisht, KKRT i ka bërë të ditur subjektit një sërë kriteresh që do të merren parasysh gjatë vlerësimit të kërkesave për rinovimin e licencës, në përputhje me pikën 4 të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së. Kjo rregullore i është dërguar zyrtarisht subjektit “TV Real”.

Konkretisht, subjekti është njoftuar se gjatë vlerësimit të kërkesës për rinovimin e licencës do të merren parasysh kriteret e mëposhtme:

1. Përcaktimi në vendimin e gjykatës i objektit ekskluziv për veprimtari radio-televizive.

2. Respektimi i kushteve të licencës, ku përfshihen:

- realizimi i mbulimit të zonës së licencimit;

- sipas territorit;

- sipas popullsisë;

- transferimi i sistemeve pikë më pikë për lidhjen e transmetuesve me studiot në brezat e dhënë nga ERT-ja;

- mbyllja e impianteve të instaluar jashtë zonës së licencimit;

- respektimi i kushteve të licencës përsa i përket programeve, kreu V i ligjit.

3. Shlyerja e detyrimeve financiare të parashikuara me ligj, ku përfshihen:

- pagesa vjetore e licencës;

- pagesa për taksat e shërbimeve radio-televizive;

- regjistrimi në organet tatimore;

- tërheqja e licencës.

- dorëzimi në KKRT i bilanceve vjetore me treguesit përkatës sipas nenit 48 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998;

- pagimi i gjobave eventuale të vendosura nga KKRT-ja.

4. Kontratat dhe pagesa e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit e siguruar

Me vendimin nr.440, datë 21.3.2006 “Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Real”, KKRT-ja ka vendosur mosrinovimin e licencës së “TV Real”, pasi gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës nga ana e subjektit televiziv “TV Real” nuk janë respektuar kërkesat e ligjit dhe kushtet e licencës: subjekti nuk ka shlyer pagesën prej 240 mijë lekë - taksë për shërbime radio-televizive të vitit 2004.

Sipas pikës 2 të vendimit të mësipërm, subjektit “TV Real” iu la e drejta që brenda një afati prej 30 ditësh të parashtojë pretendimet lidhur me këtë vendim.

Në vijim të sa më sipër, subjekti televiziv vendor “TV Real” kreu shlyerjen e detyrimeve financiare.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për rinovim licence të paraqitur nga “TV Real”, KKRT-ja konstatoi disa mangësi e, në këto kushte, me vendimin nr.477, datë 29.6.2006 nuk e rinovoi licencën për “TV Real”, duke i lënë një afat 30-ditor për të parashtruar pretendimet e tij. Në respektim të këtij afati, është paraqitur dokumentacioni përkatës me nr.640 prot.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit vëren se, gjatë afatit të vlefshmërisë së licencës, subjekti televiziv vendor “TV Real” është ndëshkuar më gjohat nr.100, datë 17.11.2004 dhe nr.103, datë 15.12.2004 për transmetim të programeve që nuk i ka prodhuar vetë dhe për të cilat nuk ka marrëveshje, kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi nga subjektet e tjera radiotelevizive, prodhuesit apo shpërndarësit e autorizuar të tyre (neni 137/4, pika 7 e ligjit). Këto gjoha nuk janë shlyer nga subjekti.

KKRT-ja, vëren gjithashtu se subjekti “TV Real” vazhdon të transmetojë filma, për të cilët nuk gëzon të drejtën e transmetimit.

Në nenin 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” parashikohet që KKRT-ja vendos për rinovimin ose për shpalljen e konkurrimit të kandidaturave të reja, nëse operatori i licencuar nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e këtij ligji.

Ndërkohë, neni 34 pika 2 e ligjit, parashikon që “Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur:... nuk plotësohen kushtet për të cilat është dhënë licenca...”. Në kushtet e licencës nr.042/TVL, datë 3.1.2001 që i është dhënë shoqërisë “Real TV” sh.a. përcaktohet:

- paragrafi 3 (pika 10): “I licencuari nuk lejohet të transmetojë në Real TV programe të paaautorizuara nga prodhuesit apo subjekte që i kanë ato në pronësi”.

Në mbështetje të argumenteve që u dhanë më sipër, KKRT-ja arriti në përfundimin se, gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës nga ana e subjektit televiziv “TV Real” nuk janë respektuar kërkesat e ligjit dhe kushtet e licencës. Konkretisht, nga ana e subjektit nuk janë respektuar nenet 34, pika 2, dhe 40/1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, kushtet e licencës nr.042/TVL, paragrafi 3 (10), si dhe pika 2 e rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë RTV”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25, nenit 33, pikat 1 dhe 3, nenit 34, pika 2, nenit 40/1 dhe nenit 137/3, pika 3/c të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, si dhe të vendimeve nr.440, datë 21.3.2006 dhe nr. 477, datë 29.6.2006 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. Nuk rinovohet licenca nr.042/TVL dhënë shoqërisë “Real TV” sh.a. në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, për televizionin “Real”.
2. Licenca, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti televiziv vendor “TV Real” detyrohet të ndërpresë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.2, datë 20.10.2006

PËR SKEMËN EKZISTUESE PËR HUANË E BUTË QË JEPET PËR MAKINERITË BUJQËSORE DHE PËR LINJAT E AGROPËRPUNIMIT

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese për huanë e butë që jepet për makineritë bujqësore dhe për linjat e agropërpunimit”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.2029, datë 24.7.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AI/011/2005.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 2 shkronja 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

Skema e dhënë nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Në kuadër të detyrimeve të MSA-së dhe Marrëveshjes së OBT-së, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

REKOMANDON:

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të bëjë një klasifikim të saktë të subjekteve përfituese mbi bazën e nënsektorëve të veçantë.
2. Llogaritja e intensitetit të skemës të bëhet duke zbatuar kriterin e kontributit edhe nga ana e përfituesit të ndihmës. Duhet të ketë një diferencim midis rajoneve të ndryshme të vendit dhe, për të nxitur investimet në zonat e thella malore, tek ato mund të aplikohet intensitet më i lartë i ndihmës.
3. Vlera maksimale e totalit të skemës, për secilin nga nënsektorët, nuk duhet të kalojë në asnjë rast kufirin prej 5% të përcaktuar në Marrëveshjen e OBT-së.

4. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të marrë parasysh vlerën përshtuese (të akumuluar) të të gjitha skemave të ndihmës që jepen në sektorët e bujqësisë, pasi kufiri prej 5% përfshin të gjitha format e ndihmës për këta sektorë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr.3, datë 20.10.2006

**PËR PËRJASHTIMIN NGA AKCIZA E KARBURANTIT TË PËRDORUR NË
LINJAT E AGROPËRPUNIMIT**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin “Për përjashtimin nga akciza e karburantit të përdorur në linjat e agropërpunimit”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.2029, datë 24.7.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.A1/010/2005.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 2 shkronja 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

Skema e dhënë nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Në kuadër të detyrimeve të MSA-së dhe Marrëveshjes së OBT-së, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

REKOMANDON:

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të bëjë një klasifikim të saktë të subjekteve përfituese mbi bazën e nënsektorëve të veçantë.

2. Llogaritja e intensitetit të skemës të bëhet duke iu referuar treguesve të GDP-së të secilit prej nënsektorëve, duke mos kaluar në asnjë rast kufirin prej 5% të përcaktuar në Marrëveshjen e OBT-së.

3. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të marrë parasysh vlerën kumulative të të gjitha skemave të ndihmës që jepen në sektorët e bujqësisë, pasi kufiri prej 5% përfshin të gjitha format e ndihmës për këta sektorë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr.4, datë 20.10.2006

**PËR PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR TË
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË SEKTORIN E PËRPUNIMIT TË
QUMËSHITIT, ULLIRIT, RRUSHIT DHE BLUARJES SË GRURIT**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin “Për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e përpunimit të qumështit, ullirit, rrushit dhe bluarjes së grurit”. Raportimi është bërë pranë

Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.2029, datë 24.7.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AI/009/2005.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 2 pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

Skema e dhënë nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Në kuadër të detyrimeve të MSA-së dhe Marrëveshjes së OBT-së, Komisioni i Ndhmës Shtetërore

REKOMANDON:

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duhet të administrojnë të dhënat për secilën nga ndërmarrjet që kanë përfituar duke llogaritur, njëkohësisht, edhe vlerën totale të ndihmës.

2. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të analizojë me imtësi efektet e ndihmës së dhënë, duke bërë një balancë midis efekteve pozitive në drejtim të rritjes së sasisë, cilësisë dhe sigurisë së produkteve të përpunuara në treg, si dhe efektit negativ në konkurrencë, për të pasur një vizion më të qartë nëse kjo skemë i ka arritur ose mund t'i arrijë në të ardhmen objektivat që ajo ka, duke dëmtuar sa më pak konkurrencën në treg.

3. Vlera maksimale e totalit të skemës, për secilin nga nënsektorët, nuk duhet të kalojë në asnjë rast kufirin prej 5% të përcaktuar në Marrëveshjen e OBT-së. Ky intensitet të llogaritet mbi bazën e akumulimit edhe të formave të tjera të ndihmës, të zbatuara për këta nënsektore.

KRYETARI

Genc Ruli

VENDIM

Nr.5, datë 20.10.2006

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË SUBVENCIONIMIT TË NDËRMARRJEVE TË UJËSJELLËSIT

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me shkresën nr.4329/4, datë 16.8.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AI/014/2005.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13 shkronja c dhe nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, në nenin 7 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005, si dhe nenin 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

PROPOZON:

1. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Brendshme, në procesin e transferimit të së drejtës së pronësisë së ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt pushtetit vendor, duhet të marrin parasysh subvencionimin e këtyre ndërmarrjeve për ofrimin e shërbimit publik.

2. Masa e subvencionit të zvogëlohet në mënyrë progresive, të jetë e kufizuar në kohë dhe

vlera e subvencionit të jetë në përpjesëtim me mangësitë që kërkon të rregullojë kjo lloj mbështetjeje. Pra subvencioni të jepet pas një analize të plotë dhe të saktë të treguesve ekonomiko-financiarë të secilës prej ndërmarrjeve dhe të mbulojë kryesisht shpenzimet për investime.

3. Subvencioni nuk duhet të tejkalojë kostot e nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimit publik dhe, në këtë rast, ofrimi i shërbimit duhet të ketë llogari të ndarë, për të shmangur çdo lloj mbikompensimi. Për përcaktimin e tarifave, rast pas rasti, dhënësit e ndihmës (MPPTT dhe organet e pushtetit vendor) duhet të bashkëpunojnë me Entin Rregullator të Ujit.

4. Subvencioni për ndërmarrjet e ujësjellësit të përcaktohet nga dhënësit e ndihmës mbi bazën e kostos që do të kishte një ndërmarrje efçente që do të ushtronte veprimtarinë në këtë sektor.

5. MPPTT dhe Ministria e Brendshme brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e këtij vendimi, të njoftojnë me shkrim pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore pranimin e masave të propozuara. Nëse nuk janë dakord me ndonjërin prej këtyre masave, brenda të njëjtit afat, të japin me shkrim argumentet përkatëse.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr.6, datë 20.10.2006

PËR PLANIN PËR DHËNIEN E NDIHMËS SHTETËRORE SHTËPISË BOTUESE
“NAIM FRASHËRI”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin “Për planin për dhënie e ndihmës shtetërore shtëpisë botuese “Naim Frashëri”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me shkresën nr.8987, datë 14.9.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.1, datë 19.9.2006.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 4 dhe nenin 22 pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë planin për dhënie e subvencionit shtëpisë botuese “Naim Frashëri” për financimin e projektit “Botimi i veprës dramatike të Gjergj Fishtës”, pasi ai përbën ndihmë shtetërore të ndaluar.

2. MTKRS, për vënien në zbatim të projekteve për botimin e veprave të tilla të trashëgimisë kulturore, duhet të ndjekë procedurat e prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr.7, datë 20.10.2006

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR PARAQITJEN E ANKESAVE PËR
NDIHMAT E PALIGJSHME DHE VLERËSIMIN E NDIHMAVE TË PALIGJSHME”

Në mbështetje të nenit 17 shkronja e të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit “Për paraqitjen e ankesave për ndihmat e paligjshme dhe vlerësimin e ndihmave të paligjshme”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

UDHËZIM

PËR PARAQITJEN E ANKESAVE PËR NDIHMAT E PALIGJSHME DHE VLERËSIMIN E NDIHMAVE TË PALIGJSHME

Neni 27 i ligjit nr.9374, datë 21.4. 2005 “Për ndihmën shtetërore” përcakton që në rastet e ndihmës së paligjshme, kur merret një vendim për moslejimin e saj, Komisioni urdhëron kthimin e ndihmës nga përfituesi i saj. Ndihma që kthehet, duhet të përfshijë interesin me një normë të përshtatshme. Interesi paguhet që nga data, në të cilën ndihma e paligjshme është në dispozicion të përfituesit deri në datën e kthimit të saj.

Në këto kushte, Komisioni informon dhënësit e ndihmës, në çdo vendim të marrë prej tij, ku urdhëron kthimin e ndihmës së paligjshme, që ata si bazë të interesit tregtar duhet të zbatojnë të njëjtën normë interesi që është përdorur në llogaritjen e ekuivalentit neto të grantit për masat e ndihmës rajonale.

Objekti i kthimit ka të bëjë me rivendosjen e gjendjes së mëparshme. Duke paguar dhe një herë ndihmën, përfituesi humb përparësinë që gëzonte në mënyrë të padrejtë në krahasim me konkurrentët e tjerë në treg dhe kushtet e konkurrencës kthehen në gjendjen që ishin para pagesës së ndihmës. Ndërkohë, vetë pagesa e interesit përbën penalizimin për përfituesin që e ka marrë ndihmën në mënyrë të paligjshme.

Normat e interesit që mund të zbatohen kur urdhërohet kthimi i ndihmës së dhënë në mënyrë të paligjshme

Interesi i thjeshtë dhe i përbërë

Zakonisht, interesi i thjeshtë llogaritet kur përfituesi i grantit nuk e ka përdorur masën e interesit para përfundimit të periudhës, për shembull kur interesi paguhet vetëm në fund të periudhës.

Llogaritja e interesit të thjeshtë kryhet me formulën:

Interesi = (kapital × norma e interesit × numri i viteve).

Ndërsa interesi i përbërë llogaritet në rast se çdo vit (ose periudhë) masa e interesit mund të konsiderohet si e paguar te përfituesi dhe, kështu, i shtohet masës së kapitalit fillestar. Në këtë rast, përfituesi mund të fitojë interes mbi bazën e interesit të paguar për çdo periudhë.

Llogaritja e interesit të përbërë, për një vit kryhet, me formulën:

Interesi = $\text{ëkapital} (1 + \text{normën e interesit})^{\text{Numrin e viteve}} - \text{Kapital}$.

Interesi për lloje të ndryshme ndihme

Në praktikë, lloji i ndihmës së dhënë dhe situata e përfituesit individual mund të ndryshojë nga njëri rast në tjetrin. Në rast se ndihma konsiston në mbikompensim, përfitimi që ndërmarrja ka marrë prej saj mund të asimilohet në një depozitë që, normalisht, mund të tërheqë interesin e përbërë.

Në rast se ndihma do të ishte një ndihmë për investim lidhur me kostot e pranueshme, ndihma mund të ketë zëvendësuar një burim alternativ financimi, i cili, gjithashtu, mund të përballojë interesin e përbërë me normat e tregut.

Në rast se ndihma do të ishte një ndihmë operacionale, do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në pasqyrën humbje-fitim, pra në bilanc, duke krijuar kështu fonde të disponueshme për t'u depozituar.

Kështu që, pavarësisht nga situatat e ndryshme, dhënia e ndihmës së paligjshme i krijon mundësinë përfituesit të saj të marrë fonde, në kushte të ngjashme me një hua të dhënë pa interes për një periudhë afatmesme. Nga ana tjetër, përdorimi i interesit të përbërë është i domosdoshëm për të siguruar se përparësitë financiare që rrjedhin nga një situatë e tillë, janë plotësisht të neutralizuara.

Komisioni informon, gjithashtu, palët e interesuara se për ndihmat rajonale mund të urdhërojnë kthimin e ndihmës së dhënë në mënyrë të paligjshme duke zbatuar normën e interesit të përbërë për të llogaritur ekuivalentin neto të grantit. Në përputhje me praktikën e tregut, llogaritja do të bëhet mbi një bazë vjetore.

Formulari i paraqitjes së ankesave lidhur me ndihmat shtetërore të paligjshme

Palët e treta kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore për ndihmat e dhëna në mënyrë të paligjshme ose ndihmat e keqpërdorura. Procedura është e lirë. Por, kur hetohen ankimet dhe merren vendimet përkatëse, Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe Komisioni i Ndhmës Shtetërore janë të detyruara të respektojnë procedurat e përcaktuara në rregulloren "Për procedurat dhe formën e njoftimit", të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005.

Formulari kërkon informacionin që duhet t'i paraqitet Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore, në mënyrë që të shqyrtohet një ankim me pretendimin e një ndihme të paligjshme. Në qoftë se nuk është e mundur të plotësohen të gjitha seksionet e formularit, ju lutemi jepni arsytet.

I. Informacion lidhur me personin që bën ankimin

I.1 Në rast se ankimi është bërë nëpërmjet një personi tjetër (një person ose një ndërmarrje), ju lutemi, gjithashtu, të jepni emrin, adresën, fax-in, adresën e e-mail të përfaqësuesit dhe bashkëngjitur provën e shkruar ku parashikohet që përfaqësuesi është i autorizuar të veprojë në emrin tuaj.

II. Informacion lidhur me dhënësin e ndihmës

II.1 Dhënësi i ndihmës:

II.2 Niveli në të cilin është dhënë ndihma shtetërore, e supozuar si e paligjshme:

- Pushtet qendror
- Pushtet vendor
- Të tjera (ju lutemi specifikoni).

III. Informacion lidhur me masën e ndihmës së supozuar të paligjshme, për të cilën po bëhet ankim

III.1 Po ankoheni për mundësinë e një skeme ndihme apo për mundësinë e një ndihme individuale?

III.2 Kur është dhënë ndihma e supozuar si e paligjshme, apo kur është zbatuar skema e ndihmës? Sa është kohëzgjatja e skemë së supozuar të paligjshme (në qoftë se dihet)?

III.3 Në cilin/ët sektor/ë zbatohet ndihma e supozuar?

III.4 Sa është masa e ndihmës së supozuar? Forma e ndihmës së dhënë (hua, grant, garanci, përjashtim apo shtyrje nga taksa etj.)?

III.5 Cila/at ndërmarrje janë përfituese? Në rastin e një skeme, cila/cilat ndërmarrje përmbushin kushtet për marrjen e një ndihme të tillë?

Ju lutemi jepni sa më shumë informacion, duke përfshirë një përshkrim të aktiviteteve të ndërmarrjes/ve përkatëse.

III.6 Për çfarë qëllimi është dhënë ndihma e supozuar e paligjshme (në qoftë se dihet)?

IV. Baza për paraqitjen e ankimit

Ju lutemi jepni me detaje ku jeni mbështetur për ankimin tuaj, duke përfshirë arsyet pse jeni ankuar, cilat dispozita të ligjit për ndihmën shtetërore mendoni se janë shkelur etj.

Në qoftë se ndihma e supozuar si e paligjshme ka dëmtuar interesat tuaja tregtare, ju lutemi shpjegoni si.

V. Informacion mbi procedura të tjera

V.1 Jepni në detaje, nëse keni pasur praktika të tjera shkresore me Drejtorinë e Ndhmës Shtetërore (në qoftë se është e mundur, kopjet e korrespondencës).

V.2 Jepni në detaje, nëse keni pasur praktika të tjera shkresore për këtë çështje me autoritetet e tjera (p.sh.: ministri, organe të qeverisjes vendore, prefekturë, bashki etj.). Nëse është e mundur, bashkëngjitni kopje të korrespondencës.

VI. Dokumentet mbështetëse

Parashtroni çdo dokument ose provë që është paraqitur në mbështetje të ankimit, dhe bashkëngjitni kopjet përkatëse.

VII. Sekreti

Theksojmë se për të respektuar të drejtën e mbrojtjes së dhënësit e ndihmës lidhur me çështjen, Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe/ose Komisioni i Ndhmës Shtetërore mund të zbulojnë te dhënësi identitetin tuaj dhe çdo dokument mbështetës, ose përmbajtjen e tyre. Në rast se nuk doni që identiteti juaj, dokumentet mbështetëse, ose çdo informacion tjetër të zbulohet, ju lutemi tregojeni këtë qartë, duke paraqitur me saktësi pjesët e çdo dokumenti, për të cilat duhet ruajtur sekreti dhe jepni arsyet tuaja.

Formulari i plotësuar duhet të dërgohet në adresën e mëposhtme:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Drejtoria e Ndhmës Shtetërore

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 2

Tiranë

Vendi, data dhe firma e ankuesit

NJOFTIM PËR VENDE VAKANTE PËR NOTER

Në zbatim të kërkesave të nenit 3 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, Ministri i Drejtësisë shpall publikisht vendet vakante për noter, si më poshtë:

Bashkia	Numri i vendeve vakant
Tropojë	1 (një)
Kukës	1 (një)
Shkodër	1 (një)
Fushë-Krujë	1 (një)
Tiranë	3 (një)
Ersekë	1 (një)
Ballsh	1 (një)

MINISTRI I DREJTËSISË

Aldo Bumçi

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.1752, datë 26.7.2006, shpall të vdekur shtetasit: Ndue Gjini Sana, Artan Mark Sagrini, Ermira Nilaj, Gjini Grishaj, Kreshnik Ndoc Bjeshka, Bute Mehmet Kodra (Dizdari), Ardian Ragip Gjilaj, Marjana Tom Narkaj.

KËRKESE

Shtetësja Hamide Kaptelli, e bija e Rrapushit dhe Hasijes, lindur në Gramsh dhe banuese në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur të djalit të saj, Klodian Kaptelli.

KËRKUESJA
Hamide Kaptelli

KËRKESE

Shtetasi Brahim Malko i biri i Qamilit dhe i Files, lindur dhe banues në Zharrnec, Lushnjë, kërkon shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, Pëllumb Qamil Malko.

KËRKUESI
Brahim Malko

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 13.11.2006

Doli nga shtypi më 15.11.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë